

ADRIANA KECO

EDLIRA RAMAJ

LIBËR PËR MËSUESIN
Qytetaria 5

Për klasën e 5-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



BOTIME



Redaktor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Enkeleda REXHA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, prill 2019

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

| | |
|---|----|
| Hyrje | 4 |
| Plani mësimor | 17 |
| Modele ditaresh | 25 |
| Modele detyrash për portofolin e nxënësit | 86 |
| Teste përmbledhëse | 92 |
| Projekte të sugjeruara | 95 |

Hyrje

I. Korniza konceptuale e programit

Programi i lëndës *Qytetari 5* në arsimin bazë është hartuar me një strukturë dhe mënyrë të re konceptimi, në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

- Ky program krijon kushtet për ndërtimin e kompetencave kyçe të të nxënës gjatë gjithë jetës në fushën e qytetarisë demokratike. Kompetencat e synuara në këtë program lidhen me kompetencat e tjera kyçe. Lidhja mes rezultateve të të nxënës të kompetencave të lëndës së qytetarisë dhe, kur është e mundur, të kompetencave të tjera kyçe, siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor. Procesi i të nxënës në fushën shoqëria dhe mjedisi, në të gjitha shkallët, ka në fokus të veçantë zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare.

- Kompetencat zhvillohen përmes tematikave të përbashkëta të fushës dhe në program zërthehen në njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të lëndës së qytetarisë, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Programi i qytetarisë për këtë shkallë të kurrikulës është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha. Për secilën prej tyre përcaktohen rezultatet e pritshme, të shprehura në terma njohurish, shkathtësish dhe qëndrimesh. Rezultatet e të nxënës të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave, ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxënës për tematikë, duke qenë pjesë integrale e tyre.

- Strukturimi dhe organizimi i programit për shkallë kurrikule synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe lënë dorë më të lirë mësuesve për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.

- Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënës për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e situatave të të nxënës dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e të nxënës janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënës. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxënës, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit/es në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit/es.

- Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Programi i lëndës së qytetarisë krijon mundësi integrimi brenda fushës dhe me fushat e tjera, si shkencat e natyrës, matematikën, gjuhën, artet etj. Në shumë aspekte, programi i lëndës së Qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare. Ato shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxënës dhe synojnë të ndihmojnë nxënës të lidhë shkollimin e tij, me jetën e përditshme.

- Programi sugjeron metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënës të tyre.

- Vlerësimi si pjesë integrale e procesit të të nxënës, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

Qëllimet e programit të lëndës së Qytetarisë

Edukimi për qytetari demokratike synon:

- të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike.

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programi i lëndës së Qytetarisë synon:

- t'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre;
- t'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit;
- t'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Lidhja e kompetencave të fushës/lëndës me kompetencat e tjera kyçe

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi/ja të mbajë parasysh lidhjen me kompetencave e tjera kyçe. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi/ja duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të nxënies.

Kompetenca qytetare

Programi i Qytetarisë, si pjesë e fushës shoqëria dhe mjedisi, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi/ja të kompetencës qytetare.

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënies të synuara nga programi i lëndës së qytetarisë nxitin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i Qytetarisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi/ja përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj., në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si t'i vlerësojë këto burime dhe të kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënies. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj., në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.

Programi i qytetarisë nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

Kompetenca e të nxënit

Për të mbështetur edukimin për qytetari demokratike, nxënësi/ja shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve. Nxënësi/ja mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi/ja mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi/ja mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

Kompetenca personale

Programi i qytetarisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësi kupton rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathëtise, dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe, që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë gjatë shkallës së dytë

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive) **Nxënësi/ja:**

- shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;
- veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë kritike dhe krijuese)**Nxënësi/ja:**

- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie;
- zgjidh një problem (shoqëror, shkencor etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse;
- përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror);
- shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë;
- krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore;
- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë)**Nxënësi/jha:**

- përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
- shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur;
- menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyrë/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)**Nxënësi/ja:**

- zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)**Nxënësi/ja:**

- vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)**Nxënësi/ja:**

- prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi, në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), tregon detyrat dhe i diskuton me bashkëmoshatarët;
- tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit;
- merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)**Nxënësi/ja:**

- përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Programi i lëndës së Qytetarisë zhvillohet në 35 orë mësimore në vit. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë, për secilën klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

Orët përkatëse mësimore të tematikave sipas programit për klasën e pestë

| Tematika/Shkalla II | Komuniteti | Qeverisja | Rruga | Europa dhe unë | Gjithsej: |
|---------------------|------------|-----------|-------|----------------|-----------|
| Klasa e pestë | 12 orë | 8 orë | 6 orë | 9 orë | 35 orë |

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas tematikave**TEMATIKA 1: INDIVIDËT, GRUPET, SHOQËRIA****Komuniteti****Nxënësi/ja:**

- tregon ç'kupton me *grup shoqëror* dhe emërton disa prej tyre;
- vendos sipas rëndësisë karakteristikat e grupit shoqëror;
- përshkruan grupet ku bën pjesë dhe të rolet që luan ai në ta;
- analizon rolin e udhëheqësit të grupit dhe përcakton cilësitë që duhet të ketë ai;
- merr pjesë në zgjedhjen e udhëheqësit të grupit ose klasës, duke i kushtuar rëndësinë procedurës së zgjedhjeve dhe të votimit;
- demonstroi aftësi në lojën me grupe, në rolin e anëtarit;
- sqaron kuptimin jashtë si dhe të udhëheqësit; e vetëpërmbytjes;
- argumenton me shembuj konkretë nga jeta e përditshme në shkollë e në komunitetin ku banon pasojat pozitive dhe negative të vetëpërmbytjes;
- demonstroi vlera të tilla si vetëpërmbytja e kompromisi në grupet ku bën pjesë;
- sqaron kuptimin e fjalës *komunitet*, dallon llojet e komuniteteve dhe përcakton çfarë i ndryshon ato nga njëri-tjetri;

- përshkruan aspekte të ndikimit të komunitetit tek njerëzit si p.sh. për të mësuar për ta bërë jetën më të gëzueshme për një komunikim më të mirë etj.;
- përshkruan se çdo të thotë të jesh qytetar i mirë në familje, në shkollë e në komunitet;
- vlerëson punën e qytetarëve për përmirësimin e jetesës në komunitet;
- tregon se ç'kupton me *grup vullnetar*, e dallon atë nga grupi shoqëror duke e ilustruar me shembuj; radhit grupet vullnetare që një;
- përshkruan një grup vullnetar në të cilin bën pjesë vetë ose shokët e tij dhe flet për rëndësinë që ka ai për komunitetin;
- dallon dhe përshkruan disa nga punët vullnetare që fëmijët dhe të rriturit mund të bëjnë, për ta bërë jetën në komunitet më të mirë;
- diskuton për rolin e një qytetari të arsimuar në përparimin e komunitetit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

TEMATIKA 2: PUSHTETI, AUTORITETI, QEVERISJA

Qeverisja

Nxënësi/ja:

- përshkruan organizimin e pushtetit vendor;
- përshkruan mënyrën se si organet e qeverisjes vendore zgjidhen nga komuniteti dhe, në të njëjtën kohë, përgjigjen para tij;
- krahason procedurën e zgjedhjeve në klasën e tij me atë që përdoret për zgjedhjen e qeverisjes lokale;
- zgjedh diskuton për rëndësinë e procedurës së zgjedhjeve dhe për dhënien llogari të njerëzve të zgjedhur para zgjedhësve;
- merr pjesë në projekte që synojnë të ndryshojnë, të vjelin mendimin e njerëzve për vendimmarrje demokratike etj.;
- zbaton në praktikë njohuritë e fituara përmes ushtrimeve praktike e projekteve.

Rruga

Nxënësi/ja:

- dallon tiparet kryesore të llojeve të ndryshme të automjeteve dhe shqyrton rreziqet që paraqesin për këmbësorët “pikat e verbra”;
- diskuton për rreziqet që paraqet kalimi prapa ose ndërmjet makinave të parkuara dhe praktikon situata konkrete;
- analizon konfliktet që lindin ndërmjet përdoruesve të ndryshëm të rrugës, për shembull ndërmjet çiklistëve dhe këmbësorëve në një vend për këmbësorë;
- shpjegon pasojat që kanë për vete dhe për të tjerët përdorimi prej tyre i kryqëzimeve dhe rrugëve të mbrojtura dhe të sigurta, duke vlerësuar pasojat e mundshme të moszbatimit të tyre;
- diskuton për ndikimin që ka sjellja e pasagjerëve për vete dhe për të tjerët (edhe për automjetet);
- jep përfundimet e tij nga informacionet që merr për rrugët dhe ngjarjet që ndodhin në to.

TEMATIKA 3: PRODHIMI, SHPËRNDARJA DHE KONSUMI

Europa dhe unë

Nxënësi/ka:

- përkufizon termin “rajon”, “burim”, “biznes” dhe “sipërmarrës”;
- dallon burimet si: natyrore, njerëzore dhe kapitale;
- përzgjedh vendndodhjen e një biznesi në një rajon;
- analizon burimet në rajone të ndryshme;
- rendit burimet e kërkuara nga biznesi i tyre për të prodhuar një të mirë dhe një shërbim;

- përzgjedh një vend për biznesin e tij duke u bazuar në burimet që ekzistojnë atje;
- përshkruan si lëndët e para bëhen të vlefshme për konsumatorët përmes vlerës së shtuar;
- tregon si lidhet vlera e shtuar e një produkti, përmes prodhimit dhe shërbimit, me çmimin e tij;
- identifikon avantazhet dhe dizavantazhet e prodhimit të produkteve në vende të caktuara;
- përkufizon “të ardhurat”, “shpenzimet”, “fitimet” dhe “humbjet”;
- tregon si i regjistron biznesi të ardhurat dhe shpenzimet;
- zgjidh probleme të thjeshta biznesi;
- përkufizon ‘pamjaftueshmërinë’ dhe shpjegon pse ajo i detyron njerëzit të bëjnë zgjedhje;
- dallon cilat janë vendimet kryesore me të cilat përballen njerëzit kur vendosin: “çfarë”, “si” dhe “pse” të prodhojnë një produkt të caktuar;
- dallon burimet që marrin pjesë në prodhimin e një produkti;
- përkufizon ekonominë dhe specializimin;
- shpjegon ndërvlerësinë ekonomike në një rajon dhe ndërmjet rajoneve të ndryshme;
- shpjegon rëndësinë e qarkullimit të parave për veprimtaritë ekonomike;
- regjistron të ardhurat dhe shpenzimet e një biznesi;
- llogarit fitimin dhe humbjen;
- tregon rolin e huasë në një biznes.

Lidhja e lëndës së Qytetarisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballen shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedis.
- Ndërvlerësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësisë qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvlerësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë njerëzore.

Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvlerësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare, dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvlerësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

Lidhjet e lëndës së Qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Lënda e Qytetarisë duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e Qytetarisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesore të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit. Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, lënda e Qytetarisë mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Shembuj

1. Historia dhe Qytetaria

Lënda e Historisë dhe ajo e Qytetarisë kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria etj.
- **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj.

Qytetaria:

U jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret Historia. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së Historisë dhe Qytetarisë?

Së pari, kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj., të trajtuara në lëndën e historisë në kurrikulën e Qytetarisë, me kusht që përmasa e Qytetarisë duhet:

- të jetë çështja thelbësore e mësimi;
- të lidhet me kurrikulën e Qytetarisë.

Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të qytetarisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtme:

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj.) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- **Tema:** Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e Qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.

- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.

- **Përmasa vendore:** Historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

1. Dituria e natyrës dhe Qytetaria

Çfarë kanë të përbashkët Dituria e natyrës dhe Qytetaria? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvlerësia etj.
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvlerësive globale etj.
- **Temat:** strehimi, komunikimi etj.

Si mund të ndihmojë lënda e Gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së Qytetarisë:

- Ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike të njerëzit dhe të bashkësisë ku jetojnë.

- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale.
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë.
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

Në ç'mënyrë lënda e Qytetarisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së Gjeografisë? Qytetaria:

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e Gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to.

- Ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së Gjeografisë.
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme.
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

Udhëzime metodologjike

Përmbajtja e lëndës së Qytetarisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në:

- ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve;
- pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake;
- përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimdhënies dhe të nxënësve, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturore, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi i kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënësve, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm midis nxënësve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dala nga nxënësit, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i nxënësve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Pretendimet e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufijve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen “disiplinën” mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione të ndryshme, këndvështrime të shumëllojshme nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të fëmijëve, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst, lënda e Qytetarisë ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si raste studimi për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të përmbushë kjo lëndë.

Në këtë kuptim, “rastet e studimit” nga komuniteti shërbejnë si ura lidhëse midis formimit të nxënësve në shkollë dhe jetën reale që përballojnë, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruarit reflektohet natyrshëm në qëndrimet që nxënësi do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket. Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë në mësimdhëniet e tyre modele të ndryshme të saj, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimdhënies ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-nxënës, mjedis fizik, material didaktike, personale të mësuesit dhe nxënësit, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë nxënësit, ku puna në grupe është e rëndësishme, por e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së Qytetarisë?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat *Dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore, teoritë dhe

çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor, përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative, (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit), parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënës, organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;

- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj, në të gjitha përmasat e tij:*
 - a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm;
 - b) në administrimin elastik të orëve të mësimi dhe të grupeve;
 - c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim;
 - d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive.*

Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tjerat;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi/ja;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuara nga kurrikula e fshehtë.

Mjedisi i të nxënës të qytetarisë demokratike

Edukimi për qytetari demokratike nxit dhe nxitet nga një mjedis të nxënës demokratik në shkollë dhe nga një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënës dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve

në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal. Ai kërkon që nxënës të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Edukimi për qytetari demokratike zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënës formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet. Edukimi për qytetari demokratike duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve në edukimin për qytetari demokratike, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe të rinjve për t'u dëgjuar, duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike,

duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave, duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës, kriterëve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të së drejtës për të shfrytëzuar TIK-un në fushën e edukimit për qytetari demokratike, duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjësisë shoqërore.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Programi i lëndës së qytetarisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënët e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë

motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që përputhet me stilet e të nxënët të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënët njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënët, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta. Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënët e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

b) Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar. Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënët brenda dhe jashtë shkollës.

Udhëzime për vlerësimin

Standardet e përmbajtjes së lëndës së Qytetarisë përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve, të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranura gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.

Aftësitë intelektuale e pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

Aftësitë pjesëmarrëse i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një pjesë të rëndësishme në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimi, në atë shkallë që është e mundshme, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse. Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike. Elementi i tretë janë prirjet qytetare që përshkruajnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë;
- për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor, për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit;
- për t'iu bindur "rregullave të lojës", si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave;
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirëinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme;
- për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare, të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohej të përshkruajnë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinioneve të të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse me parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë.

Materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën shoqëria dhe mjedisi ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë etj. Gjithashtu, burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet web për njohuri për shoqërinë.
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm *software*-sh.
- Përdorimi i simulimeve *software*.
- Përdorimi i grafikëve *software*.
- Paraqitja grafike e të dhënave.

PLANI MËSIMOR

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Qytetari

Shkalla: II

Klasa: V

Shpërndarja e orëve sipas periudhave

| Tematikat | Shtator – dhjetor (12 orë) | Janar – mars (14 orë) | Prill – qershor (9 orë) |
|---------------------------------------|-------------------------------|--------------------------|----------------------------|
| Tematika 1: Komuniteti (12 orë) | 12 orë | | |
| Tematika 2: Qeverisja (8 orë) | | 8 orë | |
| Tematika 3: Rrugë (6 orë) | | 6 orë | |
| Tematika 4: Europa dhe unë (9 orë) | | | 9 orë |

| Shtator – dhjetor 12 orë | Janar – mars 14 orë | Prill – qershor 9 orë |
|---|---------------------------------------|--------------------------|
| 1. Grupi shoqëror | | |
| 2. Grupet shoqërore ku bëj pjesë | | |
| 3. Të jesh anëtar i një grupi | | |
| 4. Nevoja e një drejtuesi në grup | | |
| 5. Veprimtari praktike: Zgjedhja e drejtuesit të grupit | | |
| 6. Si të sillemi në grup | | |
| 7. Komuniteti dhe unë | | |
| 8. Të jem qytetar i mirë | | |
| 9. Të jem vullnetar | | |
| 10. Grupet vullnetare dhe komuniteti | | |
| 11. Veprimtari praktike: Vullnetar në komunitet | | |
| 12. Përsëritje: Çfarë mësuam për komunitetin | | |
| | 1. Çfarë është pushteti vendor | |
| | 2. Bashkia | |
| | 3. Njësi të tjera të pushtetit vendor | |
| | 4. Organizimi i bashkive | |

| | | |
|--|---|--|
| | 5. Veprimtaria e bashkive | |
| | 6. Organizimi i zgjedhjeve | |
| | 7. Veprimtari praktike: Rëndësia e zgjedhjeve | |
| | 8. Përsëritje: Çfarë mësuam për qeverisjen | |
| | 9. Llojet e automjeteve | |
| | 10. Rreziqet në rrugë. Pikat e verbra | |
| | 11. Konfliktet ndërmjet përdoruesve të rrugës | |
| | 12. Sjellja e pasagjerit në automjet | |
| | 13. Veprimtari praktike: Kalimi në kryqëzim | |
| | 14. Përsëritje: Çfarë mësuam për rrugën | |
| | | 1. A jam unë sipërmarrës? |
| | | 2. Burimet rajonale: Mjetet për Sipërmarrësit |
| | | 3. Loja e kioskës ku shiten hotdogë |
| | | 4. Sipërmarrësit zgjidhin probleme |
| | | 5. Veprimtari praktike: Ne jemi sipërmarrës |
| | | 6. Sipërmarrësit zgjidhin probleme |
| | | 7. Rajoni im në botë |
| | | 8. Veprimtari praktike: Sipërmarrje jashtë komunitetit. |
| | | 9. Përsëritje: Çfarë mësuam për sipërmarrjen? Ekskursion. Vizitë në një sipërmarrje rajonale |

TREMUIORI I PARË (SHTATOR-DHJETOR)

| Nr. | Tematika | Tema mësimore | Situata e parashikuar e të nxënësve | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi (Për çfarë do të vlerësohet nxënësi) | Burimet dhe materialet didaktike |
|-----|-------------------------------|---|-------------------------------------|--|--|--|
| 1. | Komuniteti (12 orë) | Grupi shoqëror | Kush jam unë? | Lojë krijuese Lapsat në mes | - tregon ç'kupton me <i>grup shoqëror</i> dhe emërton disa prej tyre; | albume |
| 2. | | Grupet shoqërore ku bëj pjesë | Pasioni im | Vëzhgim - Diskutim Pesëvargësh | - vendos sipas rëndësisë karakteristikat e grupit shoqëror; | libra për fëmijë foto |
| 3. | | Të jesh anëtar i një grupi | Përgjegjësitë | Pyetja e ditës Përvijim i të menduarit | - përshkruan grupet ku bën pjesë dhe të rolet që luan ai në ta; | skica |
| 4. | | Nevoja e një drejtuesi në grup | Toleranca | Tryeza rrethore Shkrim i lirë | - analizon rolin e udhëheqësit të grupit dhe përcakton cilësitë që duhet të ketë ai; | filma mësimorë videokaseta kompjuter aparati projek- timi CD, DVD |
| 5. | | Veprimtari praktike: Zgjedhja e drejtuesit të grupit | Votimi | Diskutim Lojë roli | - merr pjesë në zgjedhjen e udhëheqësit të grupit ose klasës, duke i kushtuar rëndësinë procedurës së zgjedhjeve dhe të votimit; | albume libra për fëmijë |
| 6. | | Si të sillemi në grup | Vetëpërmbytja | Veprimtari në grupe Turi i galerisë Diskutim | - demonstron aftësi në lojën me grupe, në rolin e anëtarit; | foto skica |
| 7. | | Komuniteti dhe unë | Përreth nesh | Stuhi mendimi Lojë Lojë me role | - sqaron kuptimin jeshhtë si dhe të udhëheqësit; e vetëpërmbytjes; | filma mësimorë videokaseta kompjuter aparat projektimi CD, DVD |
| 8. | | Të jem qytetar i mirë | Qytetaria | Dil rrotull - Fol rrotull | - argumenton me shembuj konkretë nga jeta e përditshme në shkollë e në komunitetin ku banon pasojat pozitive dhe negative të vetëpërmbytjes; | |
| 9. | | Të jem vullnetar | Njerëzit në nevojë | Diagram i Venit | | |
| 10. | | Grupet vullnetare dhe komuniteti | Njerëzit në nevojë | Shkrim i lirë | | |
| 11. | | Veprimtari praktike: Vullnetar në komunitet | Njerëzit në nevojë | | | |

| | | | | | | |
|-----|--|--|------------|--|--|--|
| 12. | | Përsëritje: Çfarë mësuam për komunitetin | Komuniteti | | <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi vlera të tilla si vetëpërmbytja e kompromisi në grupet ku bën pjesë; - sqaron kuptimin e fjalës <i>komunitet</i>, dallon llojet e komuniteteve dhe përcakton çfarë i ndryshon ato nga njëri-tjetri; - përshkruan aspekte të ndikimit të komunitetit tek njerëzit si p.sh. për të mësuar për ta bërë jetën më të gëzueshme për një komunikim më të mirë etj.; - përshkruan se çdo tërësi të jesh qytetar i mirë në familje, në shkollë e në komunitet; - vlerëson punën e qytetarëve për përmirësimin e jetesës në komunitet; - tregon se ç'kupton me <i>grup vullnetar</i>, e dallon atë nga grupi shoqëror duke e ilustruar me shembuj; radhit grupet vullnetare që njeh; - përshkruan një grup vullnetar në të cilin bën pjesë vetë ose shokët e tij dhe flet për rëndësinë që ka ai për komunitetin; - dallon dhe përshkruan disa nga punët vullnetare që fëmijët dhe të rriturit mund të bëjnë, për ta bërë jetën në komunitet më të mirë. | |
|-----|--|--|------------|--|--|--|

TRMUJORI I DYTË (JANAR-MARS)

| Nr. | Tematika | Tema mësimore | Situata e parashikuar e të nxënësve | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi (Për çfarë do të vlerësohet nxënësi) | Burimet dhe materialet didaktike |
|-----|-----------------------------|--|---|---|--|--|
| 1. | Qeverisja (8 orë) | Çfarë është pushteti vendor | Mënyrat e qeverisjes | Pema e mendimit | -përshkruan organizimin e pushtetit vendor; | foto albume |
| 2. | | Bashkia | Vendodhja e qytetit tim | Diagram i Venit | -përshkruan mënyrën se si organet e qeverisjes vendore zgjidhen nga komuniteti dhe, në të njëjten kohë, përgjigjen para tij; | libra për fëmijë harta plane |
| 3. | | Njësi të tjera të pushtetit vendor | Mënyrat e qeverisjes vendore, qarqe, njësi. | Lojë Pyetja sjell pyetjen | | piktura dokumente historike |
| 4. | | Organizimi i bashkive | Zgjedhja e kryetarit dhe këshillit bashkiak | Lojë roli Stuhi mendimi | -krahason procedurën e zgjedhjeve në klasën e tij me atë që përdoret për zgjedhjen e qeverisjes lokale; | harta të përgjithshme ose tematike atlase |
| 5. | | Veprimtaria e bashkive | Në shërbim të komunitetit | | -zgjedh diskuton për rëndësinë e procedurës së zgjedhjeve dhe për dhënien llogari të njerëzve të zgjedhur para zgjedhësve. | filma mësimorë |
| 6. | | Organizimi i zgjedhjeve | Zgjedhjet vendore | Shkrim i lirë. | | videokaseta |
| 7. | | Veprimtari praktike: Rëndësia e zgjedhjeve | Votimi i lirë | Diskutim për njohuritë paraprake. | -merr pjesë në projekte që synojnë të ndryshojnë, të vjelin mendimin e njerëzve për vendimmarrje demokratike etj.; | komputer aparati projektimi CD, DVD |
| 8. | | Përsëritje: Çfarë mësuam për qeverisjen | Qeverisja e pushtetit vendor | Tryeza rrethore Veprimtari në grupe Turi i galerisë Marrëdhënie pyetje – përgjigje | -zbaton në praktikë njohuritë e fituara përmes ushtrimeve praktike e projekteve. | |

| | | | | | |
|-----|-------------------------|---|--------------------|--|---|
| 9. | Rruga (6 orë) | Llojet e automjeteve | Lëvizja | Shkrim i lirë Stuhi mendimi Diagram i Venit Di – Dua të di -Mësova | -dallon tiparet kryesore të llojeve të ndryshme të automjeteve dhe shqyrton rreziqet që paraqesin për këmbësorët “pikat e verbra”; - |
| 10. | | Rreziqet në rrugë. Pikat e verbra | Makinat e parkuara | | diskuton për rreziqet që paraqet kalimi prapa ose ndërmjet makinave të parkuara dhe praktikon situata konkrete; |
| 11. | | Konfliktet ndërmjet përdoruesve të rrugës | Biçikleta | | -analizon konfliktet që lindin ndërmjet përdoruesve të ndryshëm të rrugës, për shembull ndërmjet çiklistëve dhe këmbësorëve në një vend për këmbësorë; |
| 12. | | Sjellja e pasagjerit në automjet | Udhëtimet | | -shpjegon pasojat që kanë për vete dhe për të tjerët përdorimi prej tyre i kryqëzimeve dhe rrugëve të mbrojtura dhe të sigurta, duke vlerësuar pasojat e mundshme të moszbatimit të tyre; |
| 13. | | Veprimtari praktike: Kalimi në kryqëzim | Lagjja jonë | | -diskuton për ndikimin që ka sjellja e pasagjerëve për vete dhe për të tjerët (edhe për automjetet); |
| 14. | | Përsëritje: Çfarë mësuam për rrugën | Shëndeti | | -jep përfundimet e tij nga informacionet që merr për rrugët dhe ngjarjet që ndodhin në to. |


TREMUJORI I TRETË (PRILL-QERSHOR)

| Nr. | Tematika | Tema mësimore | Situata e parashikuar e të nxënësve | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi (Për çfarë do të vlerësohet nxënësi) | Burimet dhe materialet didaktike |
|-----|------------------------|--|-------------------------------------|--|--|--|
| 1 | Europa dhe unë (9 orë) | A jam unë sipërmarrës? | Blerje në panair | Veprimtari në grupe | - përkufizon termin ‘rajon’, ‘burim’, ‘biznes’ dhe ‘sipërmarrës’; -dallon burimet si: natyrore, njerëzore dhe kapitale; -përzgjedh vendndodhjen e një biznesinë një rajon; -analizon burimet në rajone tëndryshme; -rendit burimet e kërkuara nga biznesi tyre për të prodhuar një të mirë dhenjë shërbim; -përzgjedh një vend për biznesin e tij duke u bazuar në burimet që ekzistojnë atje; -përshkruan si lëndët e para bëhen të vlefshme për konsumatorët përmes vlerës së shtuar; -tregon si lidhet vlera e shtuar e një produkti, përmes prodhimit dheshërbimit, me çmimin e tij; -identifikon avantazhet dhe dezavantazhet e prodhimit të produkteve në vende të caktuara; -përkufizon ‘të ardhurat’, ‘shpenzimet’, ‘fitimet’ dhe ‘humbjet’; - tregon si i regjistron biznesi të ardhurat dhe shpenzimet; -zgjidh probleme të thjeshta biznesi -përkufizon ‘pamjaftueshmërinë’ dhe shpjegon pse ajo i detyron njerëzit të bëjnë zgjedhje | foto albume libra për fëmijë harta plane piktura dokumente historike harta të përgjithshme ose tematike atlase |
| 2 | | Burimet rajonale | Rajoni im i preferuar | Turi i galerisë | | |
| 3 | | Mjetet për sipërmarrësit. | Mjetet për biznes | Marrëdhënie pyetje – përgjigje | | |
| 4 | | Loja e kioskës ku shiten hotdogë | Biznesi i suksesshëm | Shkrim i lirë | | |
| 5 | | Veprimtari praktike: Ne jemi sipërmarrës | Krijimi i biznesit | Stuhi mendimi Diagram i Venit | | |
| 6 | | Sipërmarrësit zgjidhin probleme | Zgjidhja e problemit | Di – Dua të di -Mësova | | |
| 7 | | Rajoni im në botë | Ndërvlerësia | | | |
| 8 | | Veprimtari praktike: Sipërmarrje jashtë komunitetit. | Zgjidhja e sipërmarrësit | | | |
| 9 | | Përsëritje: Çfarë mësuam për sipërmarrjen? | Sipërmarrja | | | |



PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|---|----------|
| Tematika: Komuniteti Tema mësimore: Grupi shoqëror | | Situata e të nxënit: Kush jam unë? | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon çfarë është grupi;- dallon grupin shoqëror nga grupet e tjera;- shpjegon rëndësinë e grupeve shoqërore;- bashkëpunon me të tjerët. | | Fjalët kyçe: grup shoqëror pika të përbashkëta ndërveprim | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Lojë, Stuhi mendimi, Lexo-diskuto, Shkrim i lirë</i> | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me një prezantim që nxënësit mund të bëjnë për veten e tyre. | | | |
| Hapi 2 Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjes: <i>Çfarë dini për grupet shoqërore?</i> Pasi nxënësit mendojnë për 1-2’, shkruajnë mendimet e tyre në një fletë. Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i shkruan në tabelë pa u komentuar. | | | |
| <div></div> Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. | | | |
| Veprimet në situatë Hapi 3 Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve: <ul style="list-style-type: none">- Në sa grupe bën pjesë Sara?- Cili është grupi më i vogël në numër?- Po grupi më i rëndësishëm, cili është, sipas jush?- Po ju, në sa grupe bëni pjesë?- Si mendoni, çfarë është grupi? | | | |
| Hapi 4 Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre. <ul style="list-style-type: none">- Çfarë kuptojmë me fjalën grup?- Çfarë kanë të përbashkët anëtarët e një grupi? | | | |

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Tërhiqet vëmendja e nxënësve të tiparet e grupit shoqëror (Ndërveprim, pika të përbashkëta, qëllimi i njëjtë). Grupe shoqërore janë: banorët e një pallati, nxënësit e një klase, punonjësit e një ndërmarrjeje.

Rast studimi: Në sa grupe shoqërore bën pjesë Sara? Po Nada dhe Juli? Çfarë kanë të përbashkët ata me anëtarët e tjerë të grupeve ku bëjnë pjesë?

| <i>Fëmijët</i> | <i>Grupi ku bëjnë pjesë</i> |
|----------------|--------------------------------------|
| <i>Sara</i> | familje, klasë, shkollë, kurs baleti |
| <i>Nada</i> | familje, klasë, shkollë, kurs baleti |
| <i>Juli</i> | familje, klasë, shkollë |

Diskuto: Nxënësit japin mendimin e tyre në lidhje me pikat e përbashkëta që kanë me shokët dhe shoqet e klasës si dhe ndryshimet.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6** Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë mendimet e tyre në lidhje me temën “Grupet shoqërore janë të rëndësishme, sepse përmes tyre njerëzit komunikojnë me njëri-tjetrin.”

Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon çfarë është grupi;
- dallon grupin shoqëror nga grupet e tjera;
- shpjegon rëndësinë e grupeve shoqërore;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Duke kujtuar lëndët e tjera që bën në shkollë, gjej përdorime të tjera të fjalës “grup”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|---------------------------|--|-----------------|
| Tema mësimore: Grupet shoqërore ku bëj pjesë | | Situata e të nxënës: Pasioni im | |
| Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • tregon grupet shoqërore ku bën pjesë; • dallon grupet shoqërore kryesore dhe dytësore; • argumenton rëndësinë e zbatimit të rregullave në grup; • bashkëpunon me të tjerët. | | Fjalët kyçe: grupe shoqërore kryesore dhe dytësore | |

| | |
|---|--|
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Zhvillimi i qëndrueshëm Bashkëjetesa paqësore |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Dil rrotull-Fol rrotull, Lexo-diskuto, Ditari dypjesësh</i> | |
| Organizimi i orës së mësimi | |
| Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 | |
| Nxiten nxënësit të tregojnë si e kalojnë kohën e lirë. Lihen të shprehin emocionet dhe mendimet e tyre. | |
| Hapi 2 | |
| Nxënësit do të lëvizin në hapësirat boshe të klasës dhe do të bisedojnë me njëri-tjetrin rreth pyetjes që mësuesi/ja shkruan në tabelë: “Çfarë na bashkon në një grup shoqëror”? Diskutohen idetë e tyre me gjithë klasën dhe mësuesi/ja i shkruan në tabelë disa prej tyre. | |
| Çfarë na bashkon në një grup shoqëror? | Dëshira për të mësuar |
| Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. | |
| Veprimet në situatë | |
| Hapi 3 | |
| Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve: | |
| <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë është grupi shoqëror? - Në cilin grup shoqëror bën pjesë Olivia? - Po Idliri? - A përbëjnë grup shoqëror fëmijët që janë në autobus? Përse? | |
| Hapi 4 | |
| Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre. | |
| <ul style="list-style-type: none"> - Pse nuk janë të gjitha grupet e njerëzve grupe shoqërore? - Ku ndryshon grupi kryesor nga ai dytësor? - Pse familja dhe miqtë janë grup kryesor? | |
| Hapi 5 | |
| Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. | |
| Mendo: Grupohen grupet e dhëna në grupe të rastësishme dhe grupe shoqërore. | |
| Grupe shoqërore: anëtarët e një familjeje, kolegët e punës, anëtarët e një klubi leximi. | |
| Grupe të rastësishme: udhëtarët në një autobus, vizitorët në një muze, pjesëmarrësit në një veprimtari sportive. | |
| Plotëso: Nxënësit punojnë individualisht. Ata renditin grupet shoqërore ku bëjnë pjesë dhe përcaktojnë nëse është grup shoqëror kryesor ose dytësor. | |

- **Diskuto:** Nxënësit diskutojnë për rregullat që zbatohen në grupet shoqërore ku bëjnë pjesë dhe argumentojnë pse është e rëndësishme që të zbatohen rregullat brenda grupit. Tërhiqet vëmendja e nxënësve te nevoja e ndryshimit të rregullave me kalimin e kohës. **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6

Nxënësit shkruajnë një pasion që kanë dhe tregojnë çfarë interesash të përbashkëta kanë me anëtarët e tjerë të grupit.

| <i>Pasioni im</i> | <i>Interesat e përbashkëta me të tjerët</i> |
|-------------------|---|
| | |

Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon grupet shoqërore ku bën pjesë;
- dallon grupet shoqërore kryesore dhe dytësore;
- argumenton rëndësinë e zbatimit të rregullave në grup;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Pyet në familje për një rregull që kishit kur ishe më i/e vogël, por që tani nuk e përdorni më. Përkrahur rregullin. Diskuto përse u ndryshua ky rregull. Çfarë duhet të bësh për të ndryshuar një rregull me të cilin mund të mos jesh dakord?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|-----------------|--|----------|
| Tema mësimore: Të jesh anëtar i një grupi | | Situata e të nxënësve: Përgjegjësitë | |
| Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - tregon përgjegjësitë e tij si anëtar i grupit; - ndihmon shokët e grupit; - jep shembuj personalë ku ka treguar sjellje të përgjegjshme; - argumenton rëndësinë që ka sjellja e përgjegjshme e secilit në grup. | | Fjalët kyçe: grup të përbashkëta përgjegjësi | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësimi Bashkëjetesa paqësore | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve*Shkrim i shpejtë, Lexo-diskuto, Shkrim i lirë***Organizimi i orës së mësimi****Përshkrimi kontekstual i situatës:****Veprimtari paraprake: Hapi 1**

Organizohet një lojë e thjeshtë duke i ndarë nxënësit në dy skuadra. P.sh.: secila skuadër për 3' të shkruajë disa nga emrat qyteteve të Shqipërisë. Në fund shpallet skuadra fituese dhe tregojnë si e organizuan punën, si zbatoi secili përgjegjësitë e tij në skuadër.

Hapi 2

Nxënësit do të shkruajnë për 5', pa e shpëputur dorën nga fleta, se si sillen ata kur janë në mjedis publik.

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve pa u ndalur te gabimet drejtshkrimore. Mësuesi/ja shkruan disa prej sjelljeve të treguara nga nxënësit në tabelë.

| <i>Në mjediset publike</i> | <i>Sjellje të përgjegjshme</i> |
|----------------------------|--------------------------------|
| | <hr/> <hr/> <hr/> |

Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë.

Veprimet në situatë**Hapi 3**

Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Në cilin grup shoqëror bëjnë pjesë Joni dhe Era?
- Si mendoni se duhet të veprojë Joni që të jetë pjesë e grupit teatror?
- Po Era, çfarë duhet të bëjë? Pse?
- Përse është nevojshme që Roni të luajë për skuadrën?
- Si ndihet ai? Po anëtarët e tjerë të skuadrës?

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxitet t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë duhet të bëjmë që të jemi të përgjegjshëm?
- Pse duhet të jemi të përgjegjshëm?

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësve.

Mendo: Nxënësit lexojnë në heshtje dhe japin mendimin e tyre rreth pyetjeve: Pse shqetësohej Albana që nuk po bëhej dot gati për shfaqje? A ndiente përgjegjësi për detyrën që kishte? Çfarë mund të bënte ajo që të ishte gati për shfaqjen?

Plotëso: Nxënësit punojnë individualisht. Ata renditin grupet shoqërore ku bëjnë pjesë dhe përcaktojnë përgjegjësitë e tyre në këto grupe.

Lexohen detyra nga disa nxënës.

Diskuto: Nxënësit diskutojnë kolektivisht si duhet të sillen anëtarët, që një grup të funksionojë sa më mirë dhe plotësojnë detyrën në tekst në mënyrë të pavarur.

Më pas, ata tregojnë shembuj nga jeta në klasë kur nuk janë ndier të respektuar nga të tjerët ose kur ata nuk kanë respektuar të tjerët.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6**

Nxënësit shkruajnë për një rast kur janë treguar të përgjegjshëm.

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- tregon përgjegjësitë e tij si anëtar i grupit;
- ndihmon shokët e grupit;
- jep shembuj personalë ku ka treguar sjellje të përgjegjshme;
- argumenton rëndësinë që ka sjellja e përgjegjshme e secilit në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Sill shembuj kur ke mësuar gjëra të reja nga anëtarët e grupit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|--|----------|
| Tema mësimore: Nevoja e një drejtuesi në grup | | Situata e të nxënit: Toleranca | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon përse duhet një drejtues në grup;- dallon karakteristikat e drejtuesit të grupit;- bashkëpunon me të tjerët. | | Fjalët kyçe: drejtues anëtar përgjegjësi | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Lojë, Stuhi mendimi, Lexo-diskuto, Shkrim i lirë</i> | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me një lojë. Loja titullohet “Kush është drejtuesi?” Një nxënës duhet të dalë nga klasa. Një nxënës tjetër zgjidhet drejtues i lojës. Ai kryen lëvizje të ndryshme dhe nxënësit e tjerë imitojnë lëvizjet e tij. Nxënësi që doli jashtë, hyn mbas disa çastesh dhe duke parë lëvizjet që kryejnë nxënësit, duhet të gjejë drejtuesin e lojës. Loja përsëritet disa herë duke ndërruar drejtuesin. | | | |
| Hapi 2 Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjes: <i>Çfarë karakteristikash duhet të ketë drejtuesi i grupit?</i> Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2’, i shkruajnë mendimet e tyre në një fletë. Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i shkruan në tabelë pa u komentuar. | | | |



Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

Veprimet në situatë

Hapi 3

Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- A janë nxënësit pjesë e një grupi shoqëror?
- Si mund ta vlerësojmë grupin e tyre, kryesor apo dytësor?
- Çfarë roli luajtën Learti dhe Alba? Si e pritën ata këtë detyrë?

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre.

- Pse është e nevojshme të jetë një drejtues grupi?
- Çfarë do të thotë të jesh drejtues?

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Nxënësit lexojnë karakteristikat e drejtuesit të grupit dhe diskutojnë rreth tyre. Më pas, ata identifikojnë cila prej tyre është më e rëndësishme.

Diskuto: Nxitet diskutimi me nxënësit në lidhje me mënyrën se si zgjidhet një drejtues duke drejtuar pyetjet:

- Përse një drejtues nuk mund të zgjidhet vetë i tillë, pa pyetur askënd?
- A mund të bëjë një drejtues siç do vetë, meqenëse është drejtues? Pse?

Punë në grup: Organizohet në klasë një konkurs për paraqitjen më të mirë të dy personazheve që kanë për zemër nga librat që kanë lexuar ose filmat që kanë parë.

Ndahen nxënësit në dy grupe. Secili grup përgatitet për njërin prej tyre.

Ndahen detyrat brenda grupit. Caktohet drejtuesi i grupit dhe detyrat që do të ketë ai.

Pasi të mbarojnë konkursin, diskutojnë së bashku me drejtuesin për mënyrën si u organizua puna.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6 Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë mendimet e tyre në lidhje me temën “*Drejtuesi duhet të ndihmojë grupin për të arritur qëllimin e caktuar.*”

Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon përse duhet një drejtues në grup;
- dallon karakteristikat e drejtuesit të grupit;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Trego një rast kur ke qenë drejtues i grupit. Shpjego si ke vepruar për të kryer punën tënde dhe si je ndier.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Veprimtari praktike: Zgjedhja e drejtuesit të grupit | | Situata e të nxënit: Votimi | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- merr pjesë në zgjedhjen e udhëheqësit të grupit duke i kushtuar rëndësi procedurës së zgjedhjeve dhe të votimit;- analizon rolin e udhëheqësit të grupit dhe përcakton cilësitë që duhet të ketë ai;- demonstroi aftësi në lojë me grupe, në rolin e anëtarit;- bashkëpunon me të tjerët në veprimtari. | | Fjalët kyçe: drejtues votim zgjedhje | |
| Burimet e informacionit dhe mjetet: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, letër, laps, kuti | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake Kujtoni pse është i nevojshëm një drejtues grupi. <ul style="list-style-type: none">- Çfarë cilësish duhet të ketë një drejtues grupi?- Si zgjidhet ai?- Çfarë dini për zgjedhjen me anë të votës? Si funksionon ajo? Veprimet në situatë Zhvillohet veprimtaria në tekstin e nxënësit, hap pas hapi. Hapi i parë: Formojnë një grup dhe caktojnë qëllimin që do të ketë grupi. Për shembull, mbjellja e një peme në oborrin e shkollës ose në parkun e qytetit apo fshatit. Hapi i dytë: Pasi të formohet grupi, secili nga nxënësit, nëse ka dëshirë, mund të kërkojë të jetë drejtuesi i grupit, pra mund të kandidojë për drejtues. Secili prej kandidatëve paraqet përpara grupit idetë e tij sesi duhet të realizohet mbjellja e pemëve. Hapi i tretë: Pas paraqitjes së të gjithë kandidatëve, grupi do të votojë për drejtuesin e tij. Nxënësit shkruajnë emrin e kandidatit që i bind më shumë me idetë e tij dhe tek i cili kanë besim se do ta kryejë punën si duhet. Palosin fletën në mënyrë të tillë që emri të jetë nga brenda, në mënyrë që të mos shikohet. Përdorin një kuti kartoni për të grumbulluar fletët e tyre. | | | |

Hapi i katërt: Caktohen tre nxënës që të hapin fletët e palosura dhe të numërojnë votat për secilin kandidat.

Mësuesi/ja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe i ndihmon për çdo rast që mund të kenë nevojë.

Hapi i pestë: Diskutojnë rreth mënyrës se si vepruan për zgjedhjen e drejtuesit dhe rregullave që zbatuan gjatë votimit.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- merr pjesë në zgjedhjen e udhëheqësit të grupit duke i kushtuar rëndësi procedurës së zgjedhjeve dhe të votimit;
- analizon rolin e udhëheqësit të grupit dhe përcakton cilësitë që duhet të ketë ai;
- demonstroi aftësi në lojën me grupe, në rolin e anëtarit;
- bashkëpunon me të tjerët në veprimtari.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Përshkruaj si vepruat për zgjedhjen e drejtuesit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ / ____ / ____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Si të sillemi në grup? | | Situata e të nxënit: Vetëpërmbytja | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon si sillet me pjesëtarët e tjerë të grupit;- argumenton me shembuj konkretë nga jeta e përditshme pasojat pozitive dhe negative të vetëpërmbytjes;- demonstroi vlera të tilla si vetëpërmbytja e kompromisi në grupet ku bën pjesë;- bashkëpunon me të tjerët. | | Fjalët kyçe: kompromis vetëpërmbytje vendimmarrje | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Lojë, Stuhi mendimi, Lexo-diskuto, Shkrim i lirë</i> | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me një veprimtari të thjeshtë: Të gjithë nxënësit do të shkruajnë dy cilësi pozitive që ka shoku apo shoqja e tyre e tavolinës. Mbasi përfundojnë, lexohen nga disa nxënës dhe për cilësitë që kanë shkruar tregojnë raste apo situata që kanë ndodhur mbi të cilat bazohen për cilësitë që ata kanë zgjedhur. | | | |

Hapi 2

Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjes: *Çfarë dini për vetëpërmbytjen?* Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2', i shkruajnë mendimet e tyre në një fletë.

Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i shkruan në tabelë pa u komentuar.



Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë.

Veprimet në situatë**Hapi 3**

Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Si po e kryente Miri detyrën e tij si drejtues i grupit?
- Po Ola, si anëtare e grupit?
- Çfarë mund të ndodhte, nëse Ola do të përgjigjej menjëherë?
- Nga shembulli më sipër, si mund ta përshkruani fjalën “kompromis”?
- Po fjalën “vetëpërmbytje”?

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre.

- Çfarë është kompromisi?
- Kur është i nevojshëm ai?
- Pse është e rëndësishme vetëpërmbytja?

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësve.

Mendo: Nxënësit lexojnë situatën dhe tregojnë dhe diskutojnë rreth pyetjeve:

- Çfarë mendoni se ndodh me lojtarët, gjatë lojës? (disa mund të mërzhiten, disa ndihen të qetë dhe vazhdojnë lojën, tregojnë më shumë kujdes)

Rast studimi: Nxënësit lexojnë situatën e dhënë dhe diskutojnë rreth saj.

Vihet në dukje se në rastin konkret, vetëpërmbytja nuk është e nevojshme, sepse e vërteta është më e rëndësishme, edhe kur ajo nuk na pëlqen.

Plotëso: Nxënësit punojnë në mënyrë individuale për plotësimin e tabelës dhe më pas kontrollojnë në dyshe. Diskutohen idetë e tyre me gjithë klasën.

Diskuto: Nxënësit tregojnë raste konkrete nga jeta në klasë kur ata janë treguar të vetëpërmbytur apo kanë bërë kompromis me njëri-tjetrin.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6. Shkrim i lirë**

Nxënësit shkruajnë mendimet e tyre në lidhje me temën “*Kompromisi dhe vetëpërmbytja e forcojnë grupin*”.

Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**


- tregon si sillet me pjesëtarët e tjerë të grupit;
- argumenton me shembuj konkretë nga jeta e përditshme pasojat pozitive dhe negative të vetëpërmbytjes;
- demonstroi vlera të tilla si vetëpërmbytja e kompromisi në grupet ku bën pjesë;
- bashkëpunon me të tjerët.


Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj për një rast kur je nxituar dhe dikush e ka pësuar për shkak të mungesës së vetëpërmbytjes sate.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___ / ___ / ___

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Komuniteti dhe unë | | Situata e të nxënësve: Përreth nesh | |
| <p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none">- tregon çfarë është një komunitet;- dallon tiparet e komunitetit;- përcakton llojet e komuniteteve. | | <p>Fjalët kyçe:</p> <p>komunitet</p> <p>komunitet gjeografik,</p> <p>komunitet interesi</p> | |
| <p>Burimet e informacionit dhe mjete:</p> <p>Njohuritë paraprake të nxënësve për komunitetin, teksti mësimor,</p> <p>mjete shkrimi, ngjyra, lapsa.</p> | | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi</p> <p>Ndërvlerësimi</p> <p>Bashkëjetesa paqësore</p> | |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p><i>Stuhi mendimi, Lexo-diskuto, Tryeza rrethore</i></p> | | | |
| <p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Përshkrimi kontekstual i situatës:</p> <p>Veprimtari paraprake: Hapi 1</p> <p>Njihen nxënësve me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë.</p> <p>Hapi 2</p> <p>Nxënësit të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjes: <i>Çfarë dini për komunitetin?</i></p> <p>Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2', i shkruajnë mendimet e tyre në një fletë.</p> <p>Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i shkruan në tabelë pa u komentuar.</p> | | | |
| <div></div> | | | |



Veprimet në situatë**Hapi 3**

Nxënësit lexojnë në heshtje tekstin në hyrje dhe nënvizojnë çfarë nuk kuptojnë. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit të kuptojnë informacionin e dhënë duke drejtuar pyetjet për diskutim:

- Në cilat komunitete bën pjesë familja e Aleksës dhe Gjergjit?
- Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet këtyre komuniteteve?
- Nga se ndryshojnë ato?

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë është komuniteti?
- Çfarë është komuniteti gjeografik? Po komuniteti i interesit?
- Trego një komunitet gjeografik dhe një komunitet interesi që bëni pjesë.

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Përfundime të mundshme mund të jenë:

Mendo: Pse shqetësohet Ela? A ndihet ajo pjesë e komunitetit ku jeton? Çfarë mund të bëjë Ela? Çfarë do të ndodhte nëse të gjithë do të ndiheshin si ajo? Po nëse askush nuk do të shqetësohej?

Rast studimi: Nxënësit lexojnë rastin e dhënë dhe diskutojnë: Si u ndien familjarët e Valbonës? Çfarë mendon se do të bënin prindërit e saj atë mbrëmje? Po kur të vinin banorë të tjerë në pallatin e tyre? Pse mendoni kështu?

Nxënësit sjellin edhe raste të ngjashme nga jeta e tyre nëse kanë.

Diskuto: Nxënësit sjellin shembuj të komuniteteve të interesit dhe diskutojnë (komunitete interesi mund të jenë njerëzit që kujdesen për mjedisin, që kanë dëshirë të bëjnë shëtitje me biçikletë, që kanë dëshirë të ruajnë traditat kulturore etj.).

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6**

Nxënësit vendosen në formë rrethore (të gjithë ose me grupe) dhe japin një argument në lidhje me pyetjen:

- Çfarë të mirash ka pjesëmarrja në një komunitet?

Nxënësit japin mendimin e tyre duke e ilustruar edhe me shembuj të thjeshtë nga jeta e tyre.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- tregon çfarë është një komunitet;
- dallon tiparet e komunitetit;
- përcakton llojet e komuniteteve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Trego disa nga përgjegjësitë që kanë anëtarë e komunitetit të lagjes ku ju banoni.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| | | | |
|--|-----------------|---|----------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tema mësimore: Të jem qytetar i mirë | | Situata e të nxënit: Qytetaria | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - tregon çfarë do të thotë të jesh qytetar i mirë; - shpjegon përse duhet të jemi qytetarë të mirë. | | Fjalët kyçe: qytetar i mirë shok i mirë solidaritet | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Zhvillimi i qëndrueshëm Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim, Të nxënit në bashkëpunim, Shkrim i lirë | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit t’i përgjigjen pyetjes “Çfarë më bën mua një qytetar të mire?” dhe ta shkruajnë në një fletë. Më pas lexojnë përgjigjen e shkruar dhe mësuesi/ja i shkruan në tabelë. Qytetar të mirë më bën: Hapi 2 Nxiten nxënësit të krahasojnë përgjigjet me njëri-tjetrin. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Veprimet në situatë Hapi 3 Mësuesi/ja nxit nxënësit të mendojnë rreth situatës së paraqitur në pjesën hyrëse: - Si ju duket veprimi i Jolës? Po ai i Etienit? - Çfarë kanë të përbashkët të dyja rastet? - Çfarë i shtyn të dy fëmijët të veprojnë kështu? - Si ndihen ata? - Tregoni raste të ngjashme nga jeta. Hapi 4 Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t’u përgjigjen pyetjes: - Si mund të bëhemi qytetarë të mirë? | | | |

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo dhe plotëso: Nxënësit dallojnë sjelljet e rregullta dhe vendosin shenjën e duhur.

Të hedhësh plehrat në rrugë. G

Të ndihmosh dikë që ka nevojë për ty. V

Të kujdesesh për mjedisin ku jeton. V

Të kujdesesh vetëm për shtëpinë ku banon. G

Të ngresh zërin për problemet që shqetësojnë komunitetin. V

Rast studimi: Punohet në mënyrë individuale nga nxënësit dhe më pas diskutohet. Disa nga sjelljet e mira janë: mbjellja e pemëve, votimi, vendosja e kaskës në kokë kur ngasim biçikletën, hedhja e mbeturinave në koshin e duhur sipas llojit të mbetjeve etj.

Diskuto:

- a) Dea së bashku me familjen duhet t'u urojë mirëseardhjen banorëve të rinj.
- b) Erblini mund të shkojë te shoku dhe ta ndihmojë që të mos mbetet mbrapa me mësimet.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6**

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup rendit disa nga sjelljet që të bëjnë:

- Fëmijë të mirë në familje (ndihmon prindërit, ndihmon vëllain ose motrën më të vogël, respekton gjyshërit etj.)
- Nxënës të mirë në shkollë (mëson rregullisht, respekton shokët, zbaton rregullat, mirëmban mjetet shkollore, shkon në orar etj.)
- Aktiv në komunitet (merr pjesë në pastrimin e mjedisit përreth, nuk këput lulet ose pemët, hedh mbeturinat në kosh etj.)
- Diskutohen punët e grupeve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon çfarë do të thotë të jesh qytetar i mirë;
- shpjegon përse duhet të jemi qytetarë të mirë;
- përdor fjalor të pasur dhe argumenton mendimet.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj një tekst me titull "Si të jem qytetar i mirë?"

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|--|---|----------|
| Tema mësimore: Të jem vullnetar | | Situata e të nxënit: Njerëzit në nevojë | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon se ç’kupton me <i>grup vullnetar</i>;- dallon grupin vullnetar nga grupi shoqëror duke e ilustruar me shembuj;- radhit grupet vullnetare që njëh;- përshkruan një grup vullnetar në të cilin bën pjesë vetë ose shokët e tij;- flet për rëndësinë që ka ai për komunitetin. | | Fjalët kyçe: grup vullnetar shpirt solidariteti respekt | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, etiketa me fjalët kyçe, fletë A4, foto me pamje nga puna e grupeve vullnetare, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Lojë, Lexo-diskuto, Diskuto</i> | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të shkruajnë se çfarë do të bënin ata për të ndihmuar njerëzit në nevojë në një fletë dhe ta ngjitin në një tabak letre, të cilin mësuesja e ka titulluar “ Edhe unë ndihmoj”. Në përfundim, ekspozohet në një kënd të dukshëm të klasës. Nxiten nxënësit të diskutojnë se sa shumë gjëra mund të bëhen së bashku, nëse secili mendon dhe vepron jo vetëm për vete. | | | |
| Hapi 2 Zhvillohet loja “Bingo”. Mësuesi/ja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një, p.sh.: | | | |
| Grup | Japin ndihmesën e tyre <i>falas</i> , në të mirë të komunitetit ose të njerëzve në nevojë. | | |
| Solidaritet | Gatishmëri për të mbështetur këdo për të kapërcyer vështirësitë | | |
| Respekt | Sillem me nderim ndaj dikujt. | | |
| Ndihmë | Ndihmë që nuk shpërblehet me para. | | |

U shpërndahen nxënësve të ngatërruara dhe të kthyer përmby. Nxënësi i parë që gjen kuptimin e secilës fjalë, thotë “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesi/ja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga mësimi nëse e shikon të arsyeshme.

Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxëniti që do të arrihen në këtë orë.

Veprimet në situatë

Hapi 3

Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Si e pritën shokët kërkesën e Eltonit?
- Çfarë zgjidhjeje mund të kenë gjetur?
- Kujt mund t’u kenë kërkuar ndihmë?
- Si u ndien ata pas kësaj pune?
- A keni patur raste kur keni ndihmuar njerëz në nevojë?

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre.

- Pse nuk duhet të mendojmë vetëm për nevojat dhe dëshirat tona?
- Pse është e nevojshme puna e grupeve vullnetare?

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Duke u bazuar te fotot, nxënësit flasin për ndihmën e grupeve vullnetare: në foton e parë grupi vullnetar po kujdeset për mjedisin dhe në foton e dytë po ndihmojnë një familje me vështirësi ekonomike.

Plotëso: Nxënësit punojnë në dyshe. Ata japin mendimet e tyre rreth grupeve vullnetare në të cilat do të donin të merrnin pjesë dhe atyre që nuk do të donin duke argumentuar zgjedhjen e tyre. Nxënësit plotësojnë tabelën në mënyrë të pavarur.

Në përfundim lexohen nga disa nxënës mendimet e shprehura.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6

Diskuto:

Nxënësit duke u nisur nga përvoja dhe informacioni që mund të kenë, diskutojnë për grupet vullnetare që veprojnë në vende të ndryshme të botës. Mund të shfaqen dhe foto të këtyre grupeve nga mësuesi/ja dhe të nxitet diskutimi i nxënësve.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon se ç’kupton me *grup vullnetar*;
- dallon grupin vullnetar nga grupi shoqëror duke e ilustruar me shembuj;
- radhit grupet vullnetare që njeh;
- përshkruan një grup vullnetar në të cilin bën pjesë vetë ose shokët e tij;
- flet për rëndësinë që ka ai për komunitetin;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Grumbullo informacion në lidhje me punën e grupeve vullnetare.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| | | | | | | | | | | | | | |
|--|------------------------|--|-----------------|-----------------|------------|--|-------|--|-------|--|-------|--|-------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V | | | | | | | | | | |
| Tema mësimore: Grupet vullnetare dhe komuniteti | | Situata e të nxënit: Njerëzit në nevojë | | | | | | | | | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - tregon ndikimin e grupeve vullnetare në komunitet; - argumenton rëndësinë e punës së grupeve vullnetare; - shpjegon rëndësinë që ka ai për komunitetin; - bashkëpunon me të tjerët. | | Fjalët kyçe: organizim nismë grup vullnetar vullnetarizëm | | | | | | | | | | | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, etiketa me fjalët kyçe, fletë A4, foto me pamje nga puna e grupeve vullnetare, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësimi Bashkëjetesa paqësore | | | | | | | | | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Dil rrotull-fol rrotull, Lexo-diskuto, Diskuto</i> | | | | | | | | | | | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Kontrollohen detyrat e shtëpisë dhe diskutohen materialet që kanë gjetur nxënësit. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Hapi 2 Nxiten nxënësit të mendojnë rreth përfitimeve që mund të ketë puna vullnetare për 2-3'. Më pas ata lëvizin në hapësirat boshe të klasës dhe në momentin që mësuesja thotë "Stop" ata ndalojnë dhe këmbëjnë idetë e tyre me shokun që kanë pranë. Më pas diskutojnë me gjithë klasën. Mësuesi/ja shkruan në tabelë mendimet e nxënësve. <table border="1" data-bbox="128 1300 727 1495"> <tr> <td>Puna vullnetare</td> <td>Përfitimet</td> </tr> <tr> <td></td> <td>.....</td> </tr> <tr> <td></td> <td>.....</td> </tr> <tr> <td></td> <td>.....</td> </tr> <tr> <td></td> <td>.....</td> </tr> </table> | | | | Puna vullnetare | Përfitimet | | | | | | | | |
| Puna vullnetare | Përfitimet | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| Veprimet në situatë | | | | | | | | | | | | | |
| Hapi 3 Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve: <ul style="list-style-type: none"> - Pse u shqetësua Sara për mungesën e koshave? - Si e zgjidhi ajo këtë problem? - Çfarë mund të kishte ndodhur, nëse ajo dhe shokët nuk do të jepnin ndihmën e tyre? - Kush përfitoi nga kjo ndihmë? | | | | | | | | | | | | | |

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre.

- Pse është e rëndësishme puna vullnetare?
- Si ndihemi kur kryejmë punë vullnetare?
- Çfarë përfitimesh kemi kur kryejmë punë vullnetare?
- Çfarë të mirash sjell ajo për shoqërinë?

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Rast studimi: Nxënësit lexojnë situatën e paraqitur dhe nxiten të diskutojnë rreth saj duke u ndihmuar edhe nga pyetjet që u drejton mësuesi/ja:

- Pse shokët dhe shoqet e përkrahën studentin në këtë nismë?
- Çfarë të mirash solli vullnetarizmi në këtë rast?
- Po ty, të ka ndodhur të japësh kontributin tënd si vullnetar?

Mendo: Nxënësit punojnë në dyshe. Ata japin mendimet e tyre rreth përfitimeve që sjell puna vullnetare, jo vetëm për komunitetin, por edhe për ata vetë. Nxënësit shtojnë edhe përfitime të tjera në mënyrë të pavarur.

Në përfundim lexohen nga disa nxënës mendimet e shprehura.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6. Diskuto**

Diskutojnë për grupet vullnetare që kanë ndihmuar në komunitetin e tyre.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- tregon ndikimin e grupeve vullnetare në komunitet;
- argumenton rëndësinë e punës së grupeve vullnetare;
- shpjegon rëndësinë që ka ai për komunitetin.
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Hulumtim: Pyesni prindërit nëse kanë marrë pjesë në punë vullnetare në ndihmë të komunitetit dhe shkruani disa fjalë rreth përvojës së tyre si vullnetarë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|--|----------|
| Tema mësimore: Veprimtari praktike: Vullnetar në komunitet | | Situata e të nxënës: Njerëzit në nevojë | |
| Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - tregon ndikimin e grupeve vullnetare në komunitet; - shpjegon rëndësinë që ka ai për komunitetin; - dallon dhe përshkruan disa nga punët vullnetare që femijët dhe të rriturit mund të bëjnë, për ta bërë jetën në komunitet më të mirë; - bashkëpunon me të tjerët. | | Fjalët kyçe: Organizim nismë grup vullnetar vullnetarizëm | |

| | |
|--|--|
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, etiketa me fjalët kyçe, fletë A4, foto me pamje nga puna e grupeve vullnetare, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësimi Bashkëjetesa paqësore |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Diskuto-Punë në grupe</i> | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxëniti që do të arrihen në këtë orë. Zhvillohet një diskutim me nxënësit lidhur me problemet që mund të ketë komuniteti i tyre. <ul style="list-style-type: none"> - Si është komuniteti ku ju jetoni? - Çfarë do të donit të përmirësonit? - Si mund të kontribuoni ju që komuniteti të jetë ashtu siç e dëshironi? Hapi 2 Nxiten nxënësit të mendojnë rreth problemeve që do të donin të përmirësonin në komunitet. Organizohen në grupe dhe secili grup orientohet nga mësuesi/ja të zgjedhë një nga problemet e dhëna për të cilin do të punojë si vullnetar. Nxënësit mund të zgjedhin edhe probleme të tjera që mund të ketë komuniteti i tyre, nëse e shohin të arsyeshme. Veprimet në situatë Hapi 3 Pasi të kenë zgjedhur me cilin problem do të merren, organizojnë punën brenda grupit dhe ndajnë detyrat. Duke kujtuar nevojën e grupit për një drejtues, caktojnë një drejtues për secilin grup. Hapi 4 Nxënësit hartojnë një plan pune për grupin e tyre. Udhëzohen nga mësuesi/ja të caktojnë afatet kohore për realizimin e çdo pune përgatitore që do të bëjnë. Gjithashtu, mësuesi/ja i orienton nxënësit që të organizojnë takime brenda grupit për të ndjekur ecurinë e punës përgatitore. Hapi 5 Në klasë mund të ftohen prindër dhe anëtarë të tjerë të komunitetit dhe të përfshihen në veprimtarinë që do të kryejnë nxënësit në grupin e tyre. Hapi 6 Me ndihmën e mësueses/it dhe prindërve, njihen dhe kontaktojnë me organizatat vullnetare të komunitetit, që veprojnë në fushën e: <ul style="list-style-type: none"> ndihmës për njerëzit me aftësi ndryshe; pastrimin e mjedisit; ndihmën për njerëzit e moshuar. | |

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 7**

Puna e nisur në këtë orë mësimore, do t'i ndihmojnë nxënësit të organizojnë së bashku “Javën vullnetare në komunitet”, në të cilën ata do të japin ndihmën e tyre si vullnetarë.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- tregon ndikimin e grupeve vullnetare në komunitet;
- shpjegon rëndësinë që ka ai për komunitetin;
- dallon dhe përshkruan disa nga punët vullnetare që fëmijët dhe të rriturit mund të bëjnë, për ta bërë jetën në komunitet më të mirë;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Çfarë mendoni se do të përmirësohet në komunitetin tuaj nga puna e grupeve vullnetare?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__


| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|--|-----------------|--|----------|
| Tema mësimore: Përsëritje: Çfarë mësuam për komunitetin? | | | Situata e të nxënit: Komuniteti | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon përgjegjësitë e tij dhe të të tjerëve në komunitet;- krahason përgjegjësitë e tij dhe ato të shokëve;- sugjeron detyrime dhe përgjegjësi të çdo anëtarit të komunitetit për ruajtjen e bashkëjetesës paqësore të komunitetit;- tregon ndikimin e grupeve vullnetare në komunitet;- shpjegon rëndësinë që ka ai për komunitetin;- bashkëpunon me të tjerët. | | | Fjalët kyçe: përgjegjësi, komunitet, tolerancë, mosmarrëveshje, respekt, i përgjegjshëm, organizim, nismë, grup vullnetar, vullnetarizëm | |
| Burimet e informacionit dhe mjetet: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia, Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Lojë, Pema e mendimit, Lexo-diskuto, Punë në dyshe, Diagrami i Venit</i> | | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Zhvillohet loja “Bingo”. Mësuesi/ja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe të kapitullit dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një, p.sh.: | | | | |

| | |
|----------------|---|
| përgjegjësi | Ndjenjë e lartë që ka njeriu, i cili merr përsipër me vullnet të kryejë sa më mirë një punë, një detyrë të ngarkuar nga shoqëria etj. |
| komunitet | Grup njerëzish, që janë të lidhur e të bashkuar nga prejardhja, nga kushtet e jetesës, nga veçoritë kombëtare, nga interesa e qëllime të përbashkëta etj. |
| respekt | Nderimi që kemi për dikë duke u nisur nga mosha, nga meritat ose nga cilësitë e tij. |
| mosmarrëveshje | Mospajtim a mospërputhje mendimesh, pikëpamjesh, qëllimesh, veprimesh etj. ndërmjet dy a më shumë njerëzve. |

Nxënësi që bashkon i pari të gjitha fjalët me shpjegimet e tyre, thërret “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesi/ja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga mësimi nëse e shikon të arsyeshme.

Hapi 2

Plotësojnë pemën e mendimit duke punuar në dyshe:



Lexohet nga disa çifte.

Veprimet në situatë

Hapi 3


Nxënësit punojnë në mënyrë individuale për plotësimin e detyrave në tekst. Më pas shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe rishikojnë punën e bërë.

Në përfundim lexojnë dhe diskutojnë me gjithë klasën.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 4 Diagram i Venit

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Ata krahasojnë grupin shoqëror dhe komunitetin:



Lexohet detyra nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës: *Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*


- identifikon përgjegjësitë e tij dhe të tjerëve në komunitet;
- krahason përgjegjësitë e tij dhe ato të shokëve;
- sugjeron detyrime dhe përgjegjësi të çdo anëtarit të komunitetit për ruajtjen e bashkëjetesës paqësore të komunitetit;
- tregon ndikimin e grupeve vullnetare në komunitet;
- shpjegon rëndësinë që ka ai për komunitetin;
- dallon dhe përshkruan disa nga punët vullnetare që fëmijët dhe të rriturit mund të bëjnë, për ta bërë jetën në komunitet më të mirë;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur: Jep mendimin tënd rreth fjalisë:

“Të gjithë njerëzit janë pjesë e komunitetit, ndaj duhet të kontribuojnë për mirëqenien e tij.”

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|--|----------|
| Tematika: Qeverisja Tema mësimore: Çfarë është pushteti vendor | | Situata e të nxënët: Mënyrat e qeverisjes | |
| Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- kupton çfarë është pushteti vendor;- dallon pushtetin qendror;- përshkruan organizimin e pushtetit vendor;- bashkëpunon me të tjerët në situata. | | Fjalët kyçe: decentralizim, bashki, njësi administrative | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Lexo- diskuto, Shkrim i lirë | | | |
| Organizimi i orës së mësimit Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimit fillon me një prezantim të kapitullit për nxënësit dhe tematikat që do të punohen. Hapi 2. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës përmes pyetjes: Çfarë dini për parlamentin dhe punët që kryhen në të? Për të nxitur nxënësit mund të paraqiten foto nga Kuvendi i Shqipërisë / të vizitave të organizuar në to. Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2’, i paraqesin mendimet e tyre në një fletë. Përgjigjet e nxënësve, mësuesja i shkruan në tabelë pa u komentuar. | | | |
| <div></div> <p>Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënët që do të arrihen në këtë orë.</p> <ul style="list-style-type: none">- Veprimet në situatë <p>Hapi 3. Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none">- Ku ndodhet Kuvendi i Shqipërisë?- Kush i zgjedh deputetët e Kuvendit?- Kur janë bërë zgjedhjet e fundit për deputetë ?- Kush e drejton qeverinë ?- Kë përfaqësojnë deputetët në Kuvend? <p>Hapi 4. Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none">- Çfarë kuptojmë me pushtetin qendro po atë vendor?- Çfarë kanë të përbashkët këto dy pushtete?- Ç’ quajmë decentralizim?... | | | |

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Tërhiqet vëmendja e nxënësve për detyrat e pushteti qendror dhe atij vendor (*Pushteti qendror* - Marrëdhëniet me shtetet e huaja , mirëmbajtja e rrugëve kombëtare, siguria e rendit dhe mbrojtja e territorit. *Pushteti vendor* – Transporti publik i qytetit , administrimi i shkollave, mirëmbajtja e lulishteve.)

Diskuto: Nxënësit japin mendimin e tyre në lidhje me zgjidhjen e problemit për ndërtimin e këndit sportiv të shkollës dhe mënyrën e zgjidhjes. Për rastin konkret mund të improvizohet edhe një situatë nga vetë nxënësit.

Rast studimi: Cila do të ketë qenë zgjidhja që gjetën? Kujt mund t'i drejtohen për problemin e tyre? Çfarë kanë të përbashkët ata me anëtarët e tjerë të grupeve ku bëjnë pjesë?

Nxënësve iu kërkohet mendimi se si mund të veprojnë për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit.

- **Demonstrim i rezultateve të arritura**

Hapi 6. Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë kërkesat e tyre drejtuar kryetarit të qeverisjes vendore në lidhje me temat “Ndërtimi i këndit të argëtimit të nxënësve në shkollë”, “ Rregullimi i këndit sportiv”...

Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- kupton çfarë është pushteti vendor;
- dallon pushtetin qendror;
- përshkruan organizimin e pushtetit vendor;
- bashkëpunon me të tjerët në situatë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Diskuto me prindërit për punët që ka bërë pushteti vendor kohët e fundit për komunitetin tuaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

| Fusha:Shoqëria dhe mjedisi | Lënda:Qytetari | Shkalla:II | Klasa:V |
|---|----------------|---|---------|
| Tema mësimore: Bashkia | | Situata e të nxënësve: Vendodhja e qytetit tim | |
| Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - kupton çfarë është pushteti vendor; - emërton disa nga bashkitë që njeh; - përshkruan organizimin e pushtetit vendor në bashki; - ndan me të tjerët njohuritë dhe përvojat personale. | | Fjalët kyçe: bashki, njësi bashkiake, territor, kryeqendra e bashkisë, organizim, | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, foto të disa bashkive , harta e Shqipërisë sipas ndarjeve administrative, fletë të fotokopjuara. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Bashkëjetesa paqësore | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Vëzhgim- diskutim, Alfabeti i njëpasnjëshëm, Lexo- diskuto, pesëvargësh

Organizimi i orës së mësimi**Përshkrimi kontekstual i situatës:****Veprimtari paraprake:****Hapi 1.**

Ora e mësimi fillon me prezantimin e një harte me ndarjen administrative të Shqipërisë. Nëse është e mundur nxënësit shohin në *videoprojektor* pamje nga bashki të ndryshme të Shqipërisë. Nxënësit shohim hartën ose fotot dhe komentojnë rreth njohurive që kanë për to.

Hapi 2.

Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës përmes veprimtarisë me alfabetin e njëpasnjëshëm në tryezë. Nxënësit në dyshe shkruajnë në tabelë emrat e bashkive që ata njohin apo mbajnë mend nga vëzhgimi i mëparshëm. Ngjyrosin me të kuqe qytetin ku jetojnë.

| | | | | | |
|----|----|----|--------|----|----|
| A | B | C | Ç | D | DH |
| E | Ë | F | G | GJ | H |
| I | J | K | L | LL | M |
| N | NJ | O | P | Q | R |
| RR | S | SH | Tirana | TH | U |
| V | X | XH | Y | Z | ZH |

Veprimet në situatë

- **Hapi 3.** Lexohet informacioni hyrës dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:
- Ku ndodhet bashkia jonë në hartë?
- Nga cilat qytete përbëhet? Çfarë kanë të përbashkët?
- Cila është kryeqendra e bashkisë sonë? Pse është zgjedhur e tillë?
- Cilat bashki janë më afër me bashkësinë tuaj?
- A ekzistojnë të përbashkëta ndërmjet komunitetit dhe bashkisë?

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Shiko – diskuto. Tërhiqet vëmendja e nxënësve për listimin e nevojave të ndryshme të banorëve të bashkësive.

Rast studimi: Cilët do të përfshihen në punën për shtimin e hapësirave të gjelbra në qytet?

Çfarë kontributi ka dhënë komuniteti? A është e rëndësishme përfshirja e komunitetit?

Nxënësve iu kërkohet mendimi se si mund të veprojnë ata konkretisht për situatën.

Diskuto: Nxënësit japin mendimin e tyre për përfitimin që ka komuniteti nga punimet e bashkive si p.sh restaurimin e pazarit të vjetër të Korçës. (përfutës – komuniteti përreth, bizneset, turizmi, ekonomia...)

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6.

Nxënësit shkruajnë një pesëvargësh për fjalën

Bashkia

e nevojshme e rëndësishme
kontrollon shqyrton zbaton
Bashkia plotëson nevojat e komunitetit.
Pushteti vendor

Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:**

- kupton çfarë është pushteti vendor;
- emërton disa nga bashkitë që njeh;
- përshkruan organizimin e pushtetit vendor në bashki;
- ndan me të tjerët njohuritë dhe përvojat personale.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Diskuto me prindërit për ndihmën që jep bashkia për zhvillimin e kulturës së një vendi.

Për orën e ardhshme nxënësit këshillohen të gjejnë me ndihmën e prindërve informacione për qarqet e Shqipërisë. P.sh. foto, përshkrime për pozicionin, informacione për investimet e kohëve të fundit në qarqe, zonat turistike që mbulojnë ato...

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

| Fusha:Shoqëria dhe mjedisi | Lënda:Qytetari | Shkalla:II | Klasa:V |
|--|----------------|---|---------|
| Tema mësimore: Njësi të tjera të pushtetit vendor | | Situata e të nxënit: Mënyrat e qeverisjes vendore, qarqe, njësi. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- tregon disa njësi të pushtetit vendor;- emërton disa qarqe në Shqipëri;- dallon njësitë administrative;- bashkëpunon me grupin në situata. | | Fjalët kyçe: Qark, qendër e qarkut, bashki, njësi administrative, | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, harta e fotokopjuar e qarqeve të Shqipërisë, emërtimet e qarqeve. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pyetja sjell pyetjen, Punë në dyshe, Lexo-diskuto, Punë në grup, turi i galerisë | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1. Ora e mësimi fillon me një prezantim e hartës së faqes 36 për nxënësit.(ndarja sipas qarqeve) Shkruhet në dërrasë <i>Qark është një zonë më e madhe se bashkia.</i> Hapi 2. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës. Drejtohet pyetja: <i>Sa qarqe ka Shqipëria?</i> Për të nxitur nxënësit mund të shpërndahen fotokopje të hartës me ndarjen sipas qarqeve dhe emrat e qarqeve. Iu kërkohet nxënësve që në dyshe të bëjnë ngjitjen e tyre mbi hartë dhe nxënësit ngjyrosin qarkun ku jetojnë. Mbasi nxënësit veprojnë për 2-5’, i paraqesin punimet e tyre dhe zgjidhen punimet më të sakta e reklamohen në muret e shkollës. | | | |

Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

Veprimet në situatë

Hapi 3. Lexohet situata hyrëse dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Sa qarqe ka Shqipëria?
- Me cilat qarqe kufizohet qarku juaj?
- Cili është qarku më i vogël?
- Po qarku më i madh ?
- Pse është e nevojshme ndarja e një bashkie në njësi më të vogla?
- Si ndikon ndarja në njësi administrative në organizimin më të mirë të punës.

Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Nxënësit ndahen në grupe dhe ndiqen hapat për zhvillimin e veprimtarisë.

Fillimisht zgjidhen numrat sipas qarqeve me short.

Punohet me përshkrimet për qarkun e grupit sipas informacioneve dhe fotove përkatëse.

Konfigurohen qarqet sipas formave të ngjashme në hartë.

Realizohet një hartë e Shqipërisë me qarqet.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6. Turi i galerisë

Nxënësit ekspozojnë punimet e tyre përpara klasë. Lexohen përshkrimet e qarqeve nga disa nxënës dhe diskutohen. Përzgjidhen punimet më të mira dhe reklamohen më të mirat për tu vendosur në ambjentet e klasës ose të shkollës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- tregon disa njësi të pushtetit vendor;
- emërton disa qarqe në Shqipëri;
- dallon njësitë administrative;
- bashkëpunon me grupin në situata.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Krijo një album me përshkrimet për qarqet e Shqipërisë (nxënësit mund të veprojnë edhe për dy javë për realizimin e detyrës)

Fletë ndihmëse për veprimatritë e orës së mësim



SHKODËR
KUKËS
LEZHË
DIBËR
DURRËS
TIRANË
ELBASAN
FIER
BERAT
KORÇË
VLORE
GJIROKASTËR

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla:II | Klasa:V |
|--|-----------------|---|---------|
| Tema mësimore: Organizimi i bashkisë | | Situata e të nxënit: Zgjedhja e kryetarit dhe këshillit bashkiak | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- njeh mënyra të organizimit të bashkisë;- tregon parimet bazë të drejtimit të bashkisë;- shpjegon rëndësinë e drejtimin të bashkisë në mënyrë demokratike;- bashkëpunon me të tjerët në situata. | | Fjalët kyçe: bashki, këshilli bashkiak, kryetar i bashkisë, kandidim, votues. | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, videoprojektor, foto. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Pyetja sjell pyetjen, Lexo - diskuto, Punë në grup, Shkrim i lirë | | | |
| Organizimi i orës së mësimin Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimin fillon me vëzhgimin në videoprojektor të pamjeve e video nga mbledhjet e këshillit bashkiak . Hapi 2. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës përmes pyetjeve: <i>Çfarë dini për votimet?</i> Kush zgjidhet në to? Kur organizohen? Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2', i paraqesin mendimet e tyre të argumentuara. Përgjigjet e nxënësve, mësuesja i shkruan në tabelë. Njihen nxënësit me temën e mësimin dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Veprimet në situatë Hapi 3. Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve: <ul style="list-style-type: none">- Pse është e nevojshme që organet e bashkisë të votohen nga banorët e saj?- Cili është kryetari i bashkisë suaj?- Cila është mosha e votuesve?- Pse është e nevojshme të votojmë përfaqësuesit tanë ?- Ç’do të thotë shprehja” një kandidat ka shumicën e votave” ? Hapi 4. Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten të shprehin mendimin e tyre. <ul style="list-style-type: none">- Çfarë kriteresh duhet të plotësojë një kandidat për të qenë kryetar bashkie?- Cilët janë pjesëmarrës të këshillit bashkiak?- Cilat janë disa nga punët që kryen një kryetar bashkie ?... Hapi 5. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. | | | |

Punë në grup: Nxënësit në grup bashkëveprojnë për zbërthimin e skemës për zgjedhjet e pushtetit vendor.

Mendo: Nxënësit punojnë në libër për listimin e cilësive që duhet të ketë një kryetar bashkie.

Diskuto: Nxënësit japin mendimin e tyre në lidhje me ndihmesën e qytetarëve për organizimin e punëve të bashkësisë. Për rastin konkret mund të improvizohet edhe një situatë.

Nxënësve iu kërkohet mendimi se si mund të veprojnë për zgjidhjen e një problemi që kanë qytetarët .

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6. Pesëvargësh

Nxënësit lexojnë kuriozitetin për kryetarin e bashkisë dhe më pas plotësojnë një pesëvargësh për të. Lexohen shkrimet nga disa nxënës.

Kryetar
i drejtë i përkushtuar
organizon bashkëpunon ndihmon
Kryetari është përfaqësues i popullit.
Drejtues

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:

- njeh mënyra të organizimit të bashkisë;
- tregon parimet bazë të drejtimit të bashkisë;
- shpjegon rëndësinë e drejtimit të bashkisë në mënyrë demokratike;
- bashkëpunon me të tjerët në situata.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Trego një ose disa arsye pse do të doje të ishe kryetar i bashkisë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha:Shoqëria dhe mjedisi | Lënda:Qytetari | Shkalla:II | Klasa:V |
|---|-----------------------|---|----------------|
| Tema mësimore: Veprimtaria e bashkive | | Situata e të nxënit: Në shërbim të komunitetit | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan organizimin e veprimtarisë së bashkisë; - identifikon detyrat e kryetarit të bashkisë; - njeh detyrat e këshillit bashkiak; - bashkëpunon në grupe; - jep mendime të argumentuara për situatat. | | Fjalët kyçe: bashki, njësi administrative, drejton , përfaqëson | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4 mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Bashkëjetesa paqësore | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Vëzhgim - komentim, Lexo- diskuto- ndërvepro, Bashkëbisedim

Organizimi i orës së mësimit**Përshkrimi kontekstual i situatës:*****Veprimtari paraprake:******Hapi 1.***

Ora e mësimit fillon me prezantimin e titullit të mësimit si dhe të fotove nga mbledhje të ndryshme të këshillit bashkiak. <https://portavendore.al/hyrnebashki/mbledhjet-e-hapura-te-keshillit-bashkiak/> .

Hapi 2.

Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës duke u shoqëruar edhe me leximin e informacioneve në faqen e hapur.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

Veprimet në situatë

Hapi 3. Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Cilat janë disa nga kompetencat e kryetarit të bashkisë?
- Kush e drejton administratën e bashkisë?
- Si veprojnë këshilltarët e këshillit bashkiak?
- A është e rëndësishme mbajtja e premtimeve nga kryetari i bashkisë? Pse?

Hapi 4. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Nxënësit lexojnë situatën e dhënë dhe japin mendimet se si mund të zgjidhen ato.

Diskuto: Nxënësit japin mendimin e tyre në lidhje me zgjidhjen e problemeve për pastrimin e qytetit, sistemimin e rrugëve për biçikleta, mbrojtjen e drurëve e pyjeve. Për rastin konkret mund të improvizohet edhe një situatë e ngjashme me lojë roli.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Veprimtari . Pyetje – përgjigje. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje informacionin e ofruar nga përfaqësuesi i pushtetit vendor. Për disa nga informacionet nxënësit drejtojnë pyetje konkrete. Për problemet që kanë apo do të donin të zgjidhnin nxënësit bashkëbisedojnë me përfaqësuesin e bashkisë. (mund të realizohet edhe një lidhje me skype në rast nevojë).

Vlerësimi i situatës:***Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:***


- përshkruan organizimin e veprimtarisë së bashkisë;
- identifikon detyrat e kryetarit të bashkisë;
- njeh detyrat e këshillit bashkiak;
- bashkëpunon në grupe;
- jep mendime të argumentuara për situatat.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Diskuto me prindërit për titujt që ka dhënë bashkia për banorët e qytetit tuaj. Përgatitni një prezantim me poster për të.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha:Shoqëria dhe mjedisi | Lënda:Qytetari | Shkalla:II | Klasa:V |
|---|----------------|---|---------|
| Tema mësimore: Organizimi i zgjedhjeve | | Situata e të nxënit: Zgjedhjet vendore | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- përshkruan organizimin e zgjedhjeve;- shpjegon rëndësinë e votës së lirë;- përshkruan hapat që ndiqen gjatë votimit;- bashkëpunon me të tjerët në situata. | | Fjalët kyçe: Zgjedhje, votues, kandidat, këshill bashkiak, pjesëmarrës, | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Lexo- diskuto, Lojë roli | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: | | | |
| Hapi 1. Ora e mësimi fillon me një prezantim e një foto | |  kuti votimi. Drejtohen pyetjet? Përse përdoret kjo kuti? Ku e keni parë?... | |
| Hapi 2. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës përmes komentit për fjalinë e shkruar në dërrasë.Për të nxitur nxënësit mund të paraqiten foto nga procedura votimi. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Veprimet në situatë | | <div>Të votosh është një detyrë qytetare.</div> | |
| Hapi 3. Lexohet situata hyrëse në heshtje dhe nxitet diskutimi me anë të pyetjeve: <ul style="list-style-type: none">- Kur zhvillohen zgjedhjet për këshillin bashkiak ?- Kush voton në familjen tuaj?- Mendon se të gjithë marrin pjesë në zgjedhje?- Kush i organizon ato ?- Kë përfaqësojnë anëtarët e këshillit? | | | |
| Hapi 4. Mësuesja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Diskutohet për hapat që ndiqen gjatë votimit: Nxënësit japin mendimin e tyre në lidhje me procedurën e votimit të nxitur nga fotot dhe udhëzimet përkatëse. Rast studimi: Cilat janë zgjedhjet më të drejta e demokratike? Kujt mund t'i drejtohem për organizimin e procedurës së votimit ? | | | |

Nxënësve iu kërkohet mendimi se si mund të veprojnë për të patur zgjedhje të lira e të fshehta.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5. Lojë me role

Nxënësit ndahen në katër grupe dhe zgjedhin përfaqësuesit e tyre për kryetar përmes një votimi të lirë e të fshehtë. Në fund të votimit numërohen votat e zgjidhet kandidati më i votuar.

Kandidati fitues parashtron përpara klasës premtimet e tij të cilat mund të votohen nga klasa me kartona pro dhe kundër.

Vlerësimi i situatës:

- Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:
- përshkruan organizimin e zgjedhjeve;
- shpjegon rëndësinë e votës së lirë;
- përshkruan hapat që ndiqen gjatë votimit;
- bashkëpunon me të tjerët në situata.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Diskuto me prindërit për punët që ka bërë pushteti vendor kohët e fundit për komunitetin tuaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. __/__/__

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|--|-----------------|--|----------|
| Tema mësimore: Veprimtari praktike: Rëndësia e zgjedhjeve | | | Situata e të nxënësve: Votimi i lirë | |
| Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- tregon rëndësinë e procedurës së zgjedhjeve;- shpjegon rëndësinë që kanë zgjedhjet e lira për komunitetin;- dallon dhe përshkruan disa nga cilësitë që duhet të gëzojë një kandidat,- bashkëpunon me të tjerët. | | | Fjalët kyçe: Procedurë, kandidat, zgjedhës, votues, vota e lirë | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, etiketa me fjalët kyçe, fletë A ₄ , foto me pamje nga votime për qeverisjen vendore , mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskuto - Punë në grupe - Diagrami i Venit | | | | |

Organizimi i orës së mësimi**Përshkrimi kontekstual i situatës:****Veprimtari paraprake:****Hapi 1.**

Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënëit që do të arrihen gjatë orës.

Zhvillohet një diskutim me nxënësit lidhur me fushatën zgjedhore për zgjedhjen e senatorit të klasës.

- Kush mund të zgjidhet senator klase?
- Çfarë kushtet duhet të plotësojë një kandidat për senator?
- Si mund të realizohet votimi për të?

Hapi 2.

Nxiten nxënësit të mendojnë rreth zgjedhjeve të mëparshme në klasë .

Organizohen në grupe dhe secili grup orientohet nga mësuesja të zgjedhë një kandidat për senator. Emrat shkruhen në A_4 .

Veprimet në situatë**Hapi 3.**

Lexohen informacionet për cilësitë e një senatori dhe diskutohet rreth tyre.

Hapi 4.

Nxënësit që aspirojnë për senator hartojnë një program pune për grupin e tyre.

Udhëzohen nga mësuesja të jenë të kujdesshëm në hartimin e programit.

Gjithashtu, mësuesja i orienton nxënësit që të organizojnë takime brenda grupit për të dëgjuar nevojat dhe kërkesat e tyre.

Hapi 5.


Në klasë mund të ftohen prindër dhe anëtarë të tjerë të komunitetit dhe të përfshihen në veprimtarinë që do të kryejnë nxënësit.

Hapi 6.

Me ndihmën e mësueses dhe prindërve mund të organizohet një procedurë e thjeshtë zgjedhjesh me votë të lirë dhe të fshehtë. Kandidati fitues merr detyrën pasi bën betimin.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 7. Diagrami i Venit**

Nxënësit punojnë për plotësimin e diagramit të Venit.



Lexohen disa nga përgjigjet e nxënësve dhe komentohen.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:**

- tregon rëndësinë e procedurës së zgjedhjeve;
- shpjegon rëndësinë që kanë zgjedhjet e lira për komunitetin;
- dallon dhe përshkruan disa nga cilësitë që duhet të gëzojë një kandidat,
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Pyet prindërit për mënyrën se si janë zhvilluar zgjedhjet e fundit ku kanë marrë pjesë.

Informacion ndihmës nga libri Zgjedhja e Qeverisë së Nxënësve

KUSH MUND TË KANDIDOJË?

Çdo nxënës është i lirë të kandidojë, nëse e ndjen veten të aftë të ndihmojë dhe të japë kontributin e tij në përfaqësimin e problemeve të klasës dhe të shkollës. Ai duhet të propozohet nga shokët, e për këtë duhet të tregohet i shkathët, të mbajë fjalime, të aktivizohet në aktivitete të ndryshme, të krijojë bashkëveprim me klasën, të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla:II | Klasa:V |
|---|--|---|---|---------|
| Tema mësimore: Përsëritje: Çfarë mësua për qeverisjen? | | | Situata e të nxënit: Qeverisja e pushtetit vendor | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- identifikon qarqet në hartën e Shqipërisë;- tregon pozicionin e bashkisë ku jeton;- sugjeron mënyra të zgjidhjes së problemeve nga bashkia;- rendit problemet sipas radhës/rëndësisë që duhen zgjidhur;- liston rregulla që duhen zbatuar gjatë votimit;- argumenton mendimin për situatat. | | | Fjalët kyçe: Pushtet vendor, votimi, bashkia, qarqet, këshilli bashkiak, kryetari, problem, rregull, votimi, votë e fshehtë, votues | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, fletë të fotokopjuara, | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërrvarësia, Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë, Pema e mendimit, Lexo - diskuto, Punë në dyshe, Diagrami i Venit | | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Zhvillohet loja “ Bingo”. Mësuesja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe të kapitullit dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një ,p.sh.: | | | | |
| votues | | Të gjithë banorët e bashkisë, që kanë shtetësinë shqiptare dhe kanë mbushur moshën 18 vjeç. | | |
| komunitet | | Një organ i bërë nga shumë persona, që zgjidhen nga votuesit me zgjedhje të përgjithshme. | | |
| qark | | Përbëhet nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, shoqërore dhe interesa të përbashkëta. | | |
| pushteti vendor | | Zgjidh problemet që kanë të bëjnë me mirëqënien e komuniteteve të qyteteve dhe të fshatrave. | | |

Nxënësi që bashkon i pari të gjitha fjalët me shpjegimet e tyre, thërret “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga mësimet e mëparshme nëse e shikon të arsyeshme.

Hapi 2.

Plotësojnë pemën e mendimit duke punuar në dyshe:



Lexohet punimet nga disa çifte nxënësish.

Veprimet në situatë

Hapi 3.

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale për plotësimin e detyrave në tekst. Më pas shkëmbejnë librat me njëri- tjetrin dhe rishikojnë punën e bërë.

Në përfundim të punës lexojnë dhe diskutojnë rubrikat duke përzgjedhur më të saktat e të qartat.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 4. Diagram i Venit

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Ata krahasojnë pushtetin qendror dhe pushtetin vendor:



Lexohet detyra nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës: *Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi:*


- identifikon qarqet në hartën e Shqipërisë;
- tregon pozicionin e bashkisë ku jeton;
- sugjeron mënyra të zgjidhjes së problemeve nga bashkia;
- rendit problemet sipas radhës/rëndësisë që duhen zgjidhur;
- liston rregulla që duhen zbatuar gjatë votimit;
- argumenton mendimin për situatat.

Detyrat dhe puna e pavarur: Jep mendimin tend rreth fjalisë

“Pushteti vendor sjell përmirësime në shërbimet për qytetarët.”

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| | | | |
|--|------------------------|---|-----------------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tematika: Rruga Tema mësimore: Llojet e automjeteve | | Situata e të nxënit: Lëvizja | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon lloje të ndryshme automjeteve;- identifikon tiparet kryesore të llojeve të automjeteve. | | Fjalët kyçe: automjet, transport | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, foto të ndryshme, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Zhvillimi i qëndrueshëm | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Lexo-diskuto, Shkrim i lirë, Diagrami i Venit</i> | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: | | | |
| Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të mendojnë për lloje të ndryshme automjeteve dhe t’i shkruajnë në një fletë. Shkruhen mendimet e tyre në tabelë pa i komentuar: Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i shkruan në tabelë pa u komentuar. | | | |
| <div></div> | | | |
| Hapi 2 Paraqiten foto automjeteve të ndryshme dhe lihen nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër rreth tyre. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. | | | |
| Veprimet në situatë | | | |
| Hapi 3 Vështrojnë automjetet e paraqitura në tekst dhe diskutojnë: <ul style="list-style-type: none">- Emërtoni automjetet e mësipërme.- Si do t’i gruponi këto automjete?- Çfarë kanë të përbashkët? Nga se ndryshojnë?- Me cilin prej tyre do të doje të udhëtoje? Pse?- Çfarë dini për automjetet e hershme?- Si kanë ndryshuar ato me kalimin e kohës?- Pse automjetet janë të rëndësishme për njerëzit? | | | |

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë janë automjetet? Për se shërbejnë ato?
- Nga se dallohen nga njëri-tjetri?
- Si mund të jetë një automjet?
- Çfarë është transporti?

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Nxënësit zbulojnë sa më shumë tipare për automjetet e paraqitura.

zjarrfikësja – automjet për përdorim të veçantë, ndihmon në fikjen e zjarrit, ka alarm, është e shpejtë, ka shkallë etj.

ambulanca – automjet për përdorim të veçantë, ka alarm, është e shpejtë, ndihmon në transportimin e të sëmurëve drejt spitalit etj.

autobusi – automjet për transportin e udhëtarëve brenda qytetit ose ndërmjet qyteteve (shteteve), është i madh etj.

rulotë – përdoret për kamping, ofron komoditet gjatë udhëtimeve të gjata, përdoret nga një familje etj.

Rast studimi: Mbase Blerta mendon kështu sepse automjetet sjellin pasoja ndaj mjedisit me ndotjet që ato shkaktojnë.

Diskuto: Për transport publik përdoret autobusi dhe treni. Transporti publik është i rëndësishëm, sepse shkakton më pak ndotje ndaj mjedisit dhe më pak trafik në qytet.

Punë në grup: Duke u bazuar te fotot dhe njohuritë që kanë për makinat e së ardhmes, nxënësit do të diskutojnë për të mirat që ato kanë për mjedisin dhe vetë njerëzit.

Hapi 6**Demonstrim i rezultateve të arritura**

Nxënësit shkruajnë një tekst të shkurtër me temë “Automjetet i ndihmojnë njerëzit për të jetuar më mirë.”

Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- tregon lloje të ndryshme automjesh;
- identifikon tiparet kryesore të llojeve të automjeteve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Numëroni automjetet që do të lëvizin pranë shtëpisë tuaj për 5 minuta në orën 7, në orën 13 dhe në orën 19. Regjistroni të dhënat dhe përgatitni një grafik me shtylla.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| | | | |
|---|------------------------|---|-----------------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tema mësimore: Rreziqet në rrugë. Pikat e verbra | | Situata e të nxënit: Makinat e parkuara | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon rreziqet që paraqet kalimi pranë ose ndërmjet makinave të parkuara;- praktikon situata konkrete të kalimit pranë makinave të parkuara;- shqyrton rreziqet që paraqesin “pikat e verbra”. | | Fjalët kyçe: rrezik pikë e verbër vija të bardha | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, foto, mjete shkrimi. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedis Zhvillimi i qëndrueshëm | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Di-Dua të di-Mësova</i> | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të japin mendimin e tyre rreth respektimit të vijave të bardha në rrugë. Hapi 2 Nxënësit njihen me teknikën që do të përdoret në këtë orë mësimi dhe plotësojnë kolonën “Di”, për ato që dinë rreth rrezikut në rrugë. | | | |
| <i>Di</i> | <i>Dua të di</i> | <i>Mësova</i> | |
| | | | |
| Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet për disa minuta. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Plotësohet edhe kolona “Dua të di”. | | | |

Veprimet në situatë**Hapi 3**

Hapen librat dhe vështrojnë rreziqet e paraqitura në figurë. Nxitet diskutimi me anë të pyetjeve:

- Çfarë rreziku mund të ketë për fëmijët në figurë?
- Cilat janë gabimet në secilën figurë?
- Tregoni raste të ngjashme që mund të keni parë.
- Pse duhet të jemi të kujdesshëm kur kalojmë pranë makinave të parkuara?
- Çfarë dini për “pikat e verbra” të rrugës?

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t’u përgjigjen pyetjeve:

- Përse shërbejnë vijat e bardha?
- Pse duhet të kontrollojmë rrugën kur kalojmë?
- Çfarë pasojash mund të ketë kalimi pranë makinave të parkuara?
- Çfarë janë “pikat e verbra” të rrugës?

Hapi 5

Nxënësit plotësojnë kolonën e tretë të tabelës “Mësova”.

Lexohen nga disa nxënës.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6**

Nxënësit praktikojnë kalimin pranë makinave të parkuara në mjedisin rreth shkollës nëse është e mundur.

Në pamundësi për të dalë, modelohet një rrugë me makina të parkuara dhe praktikohen në kalimin pranë tyre.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- tregon rreziqet që paraqet kalimi pranë ose ndërmjet makinave të parkuara;
- praktikon situata konkrete të kalimit pranë makinave të parkuara;
- shqyrton rreziqet që paraqesin “pikat e verbra”.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Trego një rast kur je ndier i rrezikuar në rrugë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Konfliktet ndërmjet përdoruesve të rrugës | | | Situata e të nxënit: Biçikleta | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon konflikte që lindin ndërmjet përdoruesve të ndryshëm të rrugës;- analizon konflikte të ndryshme në rrugë;- identifikon raste aksidentesh për shkak të sjelljes së gabuar të këmbësorëve në rrugë. | | | Fjalët kyçe: përdorues rruge konflikt | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, tabela me shenja të qarkullimit rrugor, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lapsat në mes, Lexo-përmblihdh në dyshe | | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të mendojnë për 1-2’ rreth pyetjes: <ul style="list-style-type: none">- Pse mund të lindë një konflikt ndërmjet përdoruesve të rrugës? Në grupe me nga 4, ata mendohen dhe vendosin lapsin në mes të tryezës kur kanë gati përgjigjet. Nxënësit që nuk kanë informacion vendosin lapsin duke thënë “Pas”. Hapi 2 Nxënësit i japin informacionin që dinë, mësuesi/ja rendit disa prej tyre. Konflikte të ndryshme në rrugë: Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Veprimet në situatë Hapi 3 Mësuesi/ja nxit nxënësit të mendojnë rreth situatës së paraqitur në pjesën hyrëse duke drejtuar pyetjet: <ul style="list-style-type: none">- Çfarë tregon figura e parë?- Po figura e dytë?- Çfarë konflikti mund të ketë në këto raste?- Në qoftë se një çiklist duhet të kalojë nga një rrugë e lejuar vetëm për këmbësorët, si duhet të veprojë ai? | | | | |

- Të përdorë biçikletën?
- Të mos kalojë nga ajo rrugë?
- Të zbresë nga biçikleta dhe të ecë me këmbë, duke mbajtur biçikletën?
- Tregoni përvoja të ngjashme, nëse keni.

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës në dyshe me paragrafë: nxënësi 1 lexon paragrafin e parë, nxënësi 2 përmbledh dhe i drejton pyetje. Në paragrafin e dytë nxënësit ndërrojnë rolet.

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Mendo: Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Sipas jush, a ka vepruar drejt shoferi i automjetit blu? Pse?
- Kush ka të drejtë të kalojë i pari?
- Ç'konflikt mund të lindë në këtë rast?
- Si mund të mënjanohet ai?
- Jepni mendimin tuaj për fotografinë e dytë.

Diskuto:

Në rastin a): konflikti mund të lindë ndërmjet shoferit dhe këmbësorëve që kalojnë në trotuar.

Në rastin b): konflikti mund të lindë ndërmjet shitësit dhe qytetarëve që kalojnë para dyqanit.

Në rastin c): konflikti mund të lindë ndërmjet këmbësorëve, shoferëve etj.

Diskutojnë raste të tjera kur mund të lindin konflikte në rrugë dhe japin mendimin e tyre në lidhje me mënjanimin e konflikteve: duke njohur mirë rregullat në rrugë, duke i zbatuar rregullat e ecjes në rrugë, duke qenë të përgjegjshëm etj.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6

Nxënësit ndahen në grupe dhe japin mendimin e tyre rreth situatave të paraqitura.

Rast studimi:

- Konfliktet mund të lindin ngaqë nuk merren masat paraprake nga punonjësit që kryejnë punime në rrugë dhe nga mosrespektimi i rregullave nga këmbësorët ose shoferët e automjeteve.
- Konfliktet nuk lindin vetëm për faj të shoferëve të automjeteve, por edhe për shkak të këmbësorëve kur ata nuk respektojnë rregullat.

Diskutohen kolektivisht idetë e grupeve.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon konflikte që lindin ndërmjet përdoruesve të ndryshëm të rrugës;
- analizon konflikte të ndryshme në rrugë;
- identifikon raste aksidentesh për shkak të sjelljes së gabuar të këmbësorëve në rrugë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Regjistroni raste të aksidenteve, për shkak të sjelljes së gabuar të këmbësorëve në qytetin/fshatin e tyre. Përdorin mediat ose burime të tjera informacioni.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Sjellja e pasagjerit në automjet | | | Situata e të nxënit: Udhëtimet | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon sjellje të rregullta si pasagjer;- shpjegon ndikimin që ka sjellja e pasagjerëve për vete dhe për të tjerët. | | | Fjalët kyçe: pasagjer rregull | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, foto nga udhëtime të ndryshme, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi Zhvillimi i qëndrueshëm | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Di-Dua të di-Mësova | | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Nxiten nxënësit të tregojnë për udhëtimet që ata kanë bërë me familjen dhe të përshkruajnë njërin prej tyre. Hapi 2 Nxënësit plotësojnë kolonën “Di”, me rregullat që duhet të zbatohen në makinë si pasagjer. | | | | |
| Di | | Dua të di | | Mësova |
| | | | | |
| Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet për disa minuta. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Plotësohet edhe kolona “Dua të di”. | | | | |
| Veprimet në situatë | | | | |
| Hapi 3 Hapen librat dhe lexojnë situatën hyrëse të shoqëruar me figurën përkatëse. Nxitet diskutimi me anë të pyetjeve: <ul style="list-style-type: none">- Pse ua tërhoqi vëmendjen mami herën e parë?- Po herën e dytë?- Çfarë rreziku përbën sjellja e fëmijëve në secilin rast?- Si mendoni se u ndien fëmijët?- Tregoni raste të ngjashme që mund të keni parë. | | | | |

Hapi 4

Lexohet informacioni përmbledhës dhe nxiten t'u përgjigjen pyetjeve:

- Pse duhet të zbatojmë rregulla si pasagjerë në makinë?
- Pse hapja e derës së makinës kur ajo është në ecje është e rrezikshme?
- Çfarë mund të ndodhë kur grindemi më vëllanë ose motrën kur jemi në makinë?
- Si duhet të sillemi kur hipim ose zbresim nga autobusi?

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit.

Rast studimi: Dea hip me kujdes në autobus, pa u shtyrë; nuk nxjerr kokën nga dritarja; nuk grindet me shoqet ose shokët, flet me zë të ulët, zbret pa u shtyrë etj.

Plotëso: Plotësojnë tabelën në dyshe dhe diskutojnë me gjithë klasën.

| | <i>Sjellja e fëmijëve</i> | <i>Pasojat e mundshme</i> |
|-----------------|-----------------------------|---|
| <i>Figura 1</i> | Ngacmojnë njëri-tjetrin. | Tërheqin vëmendjen e prindit në timon, mund të shkaktohet aksident. |
| <i>Figura 2</i> | Ngacmon komandat e makinës | Makina mund të ndizet, të lëvizë pa kontroll dhe të shkaktojë aksident. |
| <i>Figura 3</i> | Merr timonin e makinës. | Mund të përplaset. |
| <i>Figura 4</i> | Nxjerrin kokën nga dritarja | Mund të goditen nga makinat e tjera. |

Diskuto: Nxënësit krahasojnë sjelljet e tyre me ato të fëmijëve të paraqitur në figurë.

Punë në grup: Nxënësit në grupe praktikojnë sjelljet e rregullta si pasagjerë.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6**

Nxënësit plotësojnë kolonën e tretë të tabelës “Mësova”.

Lexohen nga disa nxënës.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon sjellje të rregullta si pasagjer;
- shpjegon ndikimin që ka sjellja e pasagjerëve për vete dhe për të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj një tekst me temë “*Edukimi për sigurinë rrugore fillon që në fëmijëri*”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Veprimtari praktike: Kalimi në kryqëzim | | | Situata e të nxënit: Lagjja jonë | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- dallon kalimet jokorrekte të kryqëzimeve;- identifikon raste të kalimit të gabuar të tyre;- shpjegon pasojat që ka kalimi jokorrekt i kryqëzimeve;- praktikon kalimin e rregullt të kryqëzimit;- bashkëpunon me të tjerët në veprimtari. | | | Fjalët kyçe: kryqëzim, përdorim i rregullt | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, hartë e lagjes e printuar nga interneti, fletë me ngjyra, ngjitës, gërrshërë, kunja dhëmbësh, plastelinë, makina lodër etj. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedis | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim, Punë në grupe, Turi i galerisë | | | | |
| Organizimi i orës së mësimit | | | | |
| Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 <ul style="list-style-type: none">- Çfarë paraqet fotoja në tekst?- Pse kalimi në kryqëzim kërkon vëmendje të veçantë?- Nëse rregullat nuk zbatohen, cilët janë të rrezikuar?- Cilat shenja të qarkullimit rrugor ndihmojnë në kalimin e kryqëzimit? | | | | |
| Hapi 2 Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Diskutohen format e ndryshme të kryqëzimeve që janë në tekst ose ato që vetë nxënësit kanë parë. Lexojnë në heshtje informacionin e dhënë për kryqëzimet dhe diskutojnë rreth tij. | | | | |
| Veprimet në situatë Hapi 3 Nxënësit nxiten të diskutojnë rreth pyetjes: <ul style="list-style-type: none">- A ka kryqëzim rrugësh në lagjen tuaj?- Si vepron për kalimin e tyre? | | | | |
| Hapi 4 Zhvillohet veprimtaria në tekstin e nxënësit hap pas hapi. Hapi i parë: Ndahen në grupe me nga 4-5 nxënës. Secili grup do të përgatisë maketin e një kryqëzimi, së bashku me elementet e tij, p.sh.: vijat e bardha, semaforët etj. | | | | |

Hapi i dytë: Vendosin në fillim një karton dhe mbi të vizatojnë kryqëzimin e vijat e bardha (ose mund të priten letra me ngjyra dhe të ngjiten mbi karton).

Hapi i tretë: Përgatitin semaforë të vegjël, tabela me shenjat e qarkullimit, të përshtatshme për një kryqëzim rrugësh. Përdorni plastelinë dhe kunja dhëmbësh për t'i ngjitur. Shkruajnë rregullat që duhen zbatuar kur kalojnë në një kryqëzim.

Hapi i katërt: I vendosin në hartën e lagjes dhe praktikojnë kalimin e kryqëzimit me radhë.

Nxënësit mund të bëjnë një punë të përbashkët ose, në varësi të numrit të nxënësve të klasës, secili grup përgatit punën e vet.

Mësuesi/ja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe i ndihmon për çdo rast që mund të kenë nevojë.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5 Turi i galerisë

Nxënësit vëzhgojnë punët e grupeve dhe diskutojnë. Ata mund të drejtojnë pyetje dhe të argumentojnë punën e bërë.

Nëse është e mundur nxënësit nxirren në kryqëzimin më të afërt të lagjes, vëzhgojnë nga afër respektimin e rregullave gjatë kalimit të kryqëzimit dhe i praktikojnë ato.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- dallon kalimet jokorrekte të kryqëzimeve;
- identifikon raste të kalimit të gabuar të tyre;
- shpjegon pasojat që ka kalimi jokorrekt i kryqëzimeve;
- praktikon kalimin e rregullt të kryqëzimit;
- bashkëpunon me të tjerët në veprimtari.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Vëzhgoni gjatë një jave kalimin e kryqëzimeve dhe regjistroni në fletore sjelljet e rregullta dhe gabimet që vini re.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Përsëritje: Çfarë mësuam për rrugën? | | Situata e të nxënit: Shëndeti | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - tregon automjete të ndryshme; - përcakton tipare të automjeteve të ndryshme; - identifikon rregullat e pasagjerit në makinë; - shpjegon përgjegjësitë e përdoruesve të rrugës. | | Fjalët kyçe: rrugë rregull automjet kalim i sigurt kryqëzim pasagjer konflikt | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Mjedisi | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve*Lojë, Pema e mendimit, Rishikim në dyshe, Shkrim i lirë***Organizimi i orës së mësimi****Përshkrimi kontekstual i situatës:****Veprimtari paraprake: Hapi 1**


Zhvillohet loja “Bingo”. Mësuesi/ja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe të kapitullit dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një, p.sh.:

| | |
|-----------------|---|
| automjet | Quhet një mjet i pajisur me motor, me të paktën katër rrota. |
| “pikë e verbër” | Pjesë e rrugës që nuk mund të shikohet nga shoferi i automjetit. |
| konflikt | Quhet një mosmarrëveshje e thellë ndërmjet dy njerëzve a dy palëve. |
| transport | Quhet zhvendosja e mallrave ose lëvizja e udhëtarëve nga një vend në një vend tjetër. |
| kryqëzim | Janë bashkime të dy ose më shumë rrugëve. |

Nxënësi që bashkon i pari të gjitha fjalët me shpjegimet e tyre, thërret “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesi/ja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga mësimi nëse e shikon të arsyeshme.

Hapi 2

Plotësojnë pemën e mendimit duke punuar në dyshe:



Lexohet nga disa çifte.

Veprimet në situatë**Hapi 3**

Punohen ushtrimet në tekstin e nxënësit në mënyrë individuale dhe pastaj rishikohen në dyshe. Në përfundim diskutohen me gjithë klasën.

Detyra 1: autobus, zjarrfikëse, ambulancë, kamion, taksi. Simbolet janë të zjarrfikëses, makinës së policisë, ambulancës, taksisë.

Detyra 2: Disa nga rregullat e pasagjerëve: duhet të ulemi në sedijen e pasme, të vendosim rripin e sigurimit, nuk duhet të nxjerrim kokën ose duart në dritare, nuk duhet të lëvizim asnjë komandë të mjetit, kurrsesi nuk duhet të përpiqemi të ngasim vetë makinën, nuk duhet të grindemi me vëllanë ose motrën etj.

Detyra 3: Në çiftin e parë të fotove, vajza e dytë po vepron gabim sepse nxjerr kokën nga dritarja. Në çiftin e dytë të fotove, në foton e parë çiklisti po ecën në rrugën e këmbësorëve dhe në çiftin e tretë, gabimi është në foton e dytë, sepse fëmijët po kalojnë para autobusit.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 6

Shkrim i lirë

Nxënësit punojnë në grup për detyrën 4. Ata përgatitin një listë ose një fletëpalosje me këshilla në lidhje me përdorimin e rregullt të rrugës nga këmbësorët.

Në një moment të përshtatshëm, ata organizojnë një veprimtari për shpërndarjen e fletëpalosjeve atje ku ka më shumë fëmijë: shkollë, park, kënd lodrash etj.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon automjete të ndryshme;
- përcakton tipare të automjeteve të ndryshme;
- identifikon rregullat e pasagjerit në makinë;
- shpjegon përgjegjësitë e përdoruesve të rrugës.

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani mendimin tuaj rreth fjalisë “Në rrugë jemi të sigurt, kur i respektojmë rregullat e saj.”



PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| | | | |
|--|---|--|----------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tema mësimore: A jam unë sipërmarrës? | | Situata e të nxënësve: Blerje në panair | |
| Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">përshkruan ndikimin e sipërmarrësve në një komunitet;dallon tiparet e sipërmarrësve;shpjegon aftësitë e sipërmarrësve të suksesshëm;argumenton mendimin për zgjidhjen e situatave;bashkëpunon me të tjerët. | | Fjalët kyçe: sipërmarrës, komunitet, rajon, biznese | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ , mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pyetja e ditës, DDM, Shënime mbi shënime</i> | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me një prezantim të kapitullit “Europa dhe unë”, tematikat përkatëse si dhe objektivat e përgjithshme të tij. Hapi 2 Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjes: <i>Pse blejmë më shumë libra në panairin e librit se në librari?</i> Pasi nxënësit mendojnë për 1-2’, i shkruajnë përgjigjet e tyre në tabelë, pa i komentuar. Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënësve që do të arrihen në këtë orë. Veprimet në situatë Hapi 3 Nxënësi hapin librat. Ata ndahen në dyshe dhe udhëzohen se si do të punojnë mbi informacionin e ri. Në fillim do të lexojnë tekstin të ndarë në paragrafë dhe diskutojnë me shokun e bankës. Gjatë kësaj kohe, ata shtrojnë pyetje të ndryshme madje edhe për fjalë që nuk i kuptojnë. Mësuesi/ja ndjek punën e nxënësve dhe jep udhëzimet përkatëse. Tabela që punohet në A4 merr formën. | | | |
| Çfarë dimë? | Çfarë duam të dimë? | Mësova | |
| <ul style="list-style-type: none">Sipërmarrësit merren me biznes.Biznesi ndihmon komunitetin e shkollës financiarisht.Biznesi funksionon edhe online. | <ul style="list-style-type: none">Si mund të bëhesh një sipërmarrës biznesi në vendin tonë?A kanë ndikim sipërmarrësit në jetën e njerëzve në komunitet? | <ul style="list-style-type: none">Sipërmarrësit janë personat që përdorin burime të caktuara për të hapur një biznes.Të gjithë sipërmarrësit kanë cilësi dhe talente të ndryshme por kanë edhe tipare të përbashkëta. | |

Hapi 4

Bëhet leximi, komentimi dhe argumentimi për rubrikat e tabelës DDM.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 5: Shënime mbi shënime**

Nxënësit të ndarë sipas bankave e grupeve udhëzohen të strukturojnë shënimet në rubrikat e librit për zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe shprehive. Ata mund të renditin edhe sipërmarrësit e suksesshëm të komunitetit ku jetojnë.

Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- përshkruan ndikimin e sipërmarrësve në një komunitet;
- dallon tiparet e sipërmarrësve;
- shpjegon aftësitë e sipërmarrësve të suksesshëm;
- argumenton mendimin për zgjidhjen e situatave;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj pyetjet që do t'i drejtonit një sipërmarrësi të suksesshëm. Krijë një tabelë me sipërmarrës e produkte dhe shërbimet që ata ofrojnë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|--|-----------------|--|----------|
| Tema mësimore: Burimet rajonale | | | Situata e të nxënit: Rajoni im i preferuar | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- përshkruan burime natyrore;- dallon burimet kapitale;- njeh burimet njerëzore;- rendit burimet natyrore;- bashkëpunon me të tjerët. | | | Fjalët kyçe: Burim, burime rajonale, burime njerëzore, burime natyrore, burime kapitale, shërbime, mallra, mjedisi gjeografik | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ , mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Përvijim i të menduarit, Fragmenti - komenti, Pyetja sjell pyetjen Pse? Pse? Pse?</i> | | | | |

Organizimi i orës së mësimit


Përshkrimi kontekstual i situatës:

Veprimtari paraprake: Hapi 1

Ora e mësimit fillon me një prezantim të hartës së Europës për nxënësit.

Hapi 2

Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës mes përvijimit të të menduarit. Ata mund të qarkojnë edhe emra të vendeve që kanë vizituar apo shkuar me pushime, *si? pse?*...



Mbasi nxënësit mendojnë për 1-2', i shkruajnë mendimet e tyre në një fletë.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

Veprimet në situatë

Hapi 3

Lexohet informacioni në heshtje dhe nxitet puna për përthithjen e tij me tabelën:

| FRAGMENTI | KOMENTI |
|--|--|
| Rajoni është një zonë gjeografike me karakteristika të njëjta. Burimi është diçka që përdoret për të prodhuar një mall ose shërbim. | Çdo rajon ka karakteristikat e tij. Njeriu shfrytëzon burime të ndryshme për të realizuar qëllimet e tij. |


Hapi 4

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit. Lexohen informacionet dhe nxiten nxënësit të shprehin mendimin e tyre në rubrika.

- Çfarë ndodh nëse burimet në një zonë janë të kufizuara?
- Pse është e rëndësishme për një sipërmarrës të njohë tiparet e rajonit?

Demonstrim i rezultateve të arritura: Hapi 5

Nxënësit shkruajnë përgjigjet e tyre në lidhje me temën “Rajoni që kam vizituar në Europë”.



Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohen.

Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- përshkruan burime natyrore;
- dallon burimet kapitale;
- njeh burimet njerëzore;
- rendit burimet natyrore;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

A mund një sipërmarrës të ndërtojë një biznes në rajon pa njohur dhe pa përdorur burimet e tij. Pyesni prindërit për to.


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ / ____ / ____

| | | | | |
|--|--|------------------------|---|-----------------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tema mësimore: Mjetet për sipërmarrësit | | | Situata e të nxënit: Mjetet për biznes | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- përshkruan llojet e burimeve;- dallon produktet dhe shërbimet që ofrohen;- analizon produktet që përdoren;- përshkruan shërbimet që ofrohen;- bashkëpunon me të tjerët. | | | Fjalët kyçe: Sipërmarrës, shërbime, mallra, pajisje | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, videoprojektor | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Lexo-diskuto, Harta semantike, Shkrim i lirë</i> | | | | |
| Organizimi i orës së mësimimit Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimimit fillon me një vëzhgim të fotove apo videove të një udhëtimi në Valbonë. Prezantim i temës së mësimimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Hapi 2 Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet pyetjeve që drejtohen pas leximit të tekstit: <i>Udhëtimi për në Valbonë: Mbasi nxënësit mendojnë për 2-4', argumentojnë mendimet e tyre duke renditur në një fletë llojet e sipërmarrjeve që kanë ndikuar në realizimin e këtij udhëtimi.</i> | | | | |
| <div><i>Erdi shkoi për pushime në Valbonë. Prindërit e kishin planifikuar udhëtimin online përmes agjencisë turistike. Udhëtimi ishte pak i gjatë por shumë i bukur. Ata udhëtuan në fillim me makinë pastaj me traget në shtratin e lumit Drin. E shijuan peizazhin interesant nga pjesa e sipërme e tragetit dhe u freskuan në lokalin e vogël brenda tij me akullore artizanale. Gjatë gjithë udhëtimit të gjithë pasagjerët fotografonin pa pushim natyrën. Udhëtimi me traget e shkurtonte rrugën rreth dy orë rrugën. Kur arritën në Valbonë ata shijuan një drekë tradicionale në lokalin Hani i ri ku dhe u akomoduan gjatë natës.</i></div> | | | | |

Veprimet në situatë**Hapi 3**

Drejtohet pyetja nxitëse: Pse ishte më i lehtë udhëtimi me traget? Diskutohet rreth bizneseve pjesëmarrëse në udhëtim përmes Hartës semantike.

**Hapi 4**

Pyetja sjell pyetjen. Po të ishit sipërmarrës çfarë do të bënit ndryshe? Pse? Si?

- Çfarë mjetesh do të përdornit në biznesin tuaj?
- Mendon që ndikojnë kushtet e mjedisit në biznesin tuaj? Pse?

Hapi 5

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit të rubrika zhvillojmë shprehitë e qytetarisë.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6: Shkrim i lirë**

Nxënësit në dy grupe shkruajnë tekste me tituj: 1- Udhëtimi në zonën malore. 2- Udhëtimi në bregdet. Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohet për tipet e sipërmarrjeve dhe tiparet e tyre të ngjashme dhe të ndryshme.

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- përshkruan llojet e burimeve;
- dallon produktet dhe shërbimet që ofrohen;
- analizon produktet që përdoren;
- përshkruan shërbimet që ofrohen;
- bashkëpunon me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur:

A mundet që një sipërmarrës të ndërtojë një biznes pa njohur dhe pa përdorur burimet e rajonit ku ndërtohen?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Loja e kioskës ku shiten hotdogë | | Situata e të nxënës: Biznesi i suksesshëm | |
| Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon rëndësinë e mbajtjes së llogarisë; - ndjek të ardhurat e një biznesi; - dallon shpenzimet në një biznes; - përshkruan detyrat themelore të nevojshme për të drejtuar një biznes; - bashkëvepron në grup. | | Fjalët kyçe: Shpenzimet, reklamimet, të ardhurat, fitim, humbje, shpenzim | |

| | |
|--|--|
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ , mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, videoprojektor ose foto | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësimi Bashkëjetesa paqësore |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Lojë “Bingo”, Shënime mbi shënime, Rrjeti i diskutimit</i> | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me një prezantim e fotove nga biznese të vogla ose vëzhgimi në videoprojektor të disa bizneseve me sipërmarrës vendas. Hapi 2 Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxëniti që do të arrihen në këtë orë. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës nëpërmjet lojës “Bingo”. U jepen nxënësve fletë të kthyer përmbys me numrat 1-6 që përfaqësojnë detyrat sipas rëndësisë. Në gjashtë fleta të tjera jepen objektivat e secilës detyrë dhe nxënësit bëjnë lidhjen e tyre për 3-5 minuta sipas grupeve me 4-6 nxënës. Kush mbaron i pari thotë “bingo”. | |
| Detyra 1 | Të paguajë për burimet që u nevojiten për biznesin e tyre. Këto janë shpenzimet e biznesit. |
| Detyra 2 | ... |
| Veprimet në situatë: Hapi 3 Lexohet situata veprimtari në heshtje dhe nxiten nxënësit të ndarë në grupe të veprojnë për realizimin e detyrave që duhet të marrë një sipërmarrës. <ul style="list-style-type: none"> - D 1 – Blerja e furnizimeve - D 2 – Pagesa për reklamim - D 3 – Vendosija e çmimeve dhe shitja e hotdogëve - D 4 – Trajtimi mirë i klientëve - D 5 – Kontrolli i shpenzimeve dhe fitimeve të biznesit - D 6 – Bilanci (shpenzime – të ardhura) | |
| Hapi 4 Çdo grup veçon të ardhurat dhe shpenzimet dhe argumenton mendimet. <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë kanë të përbashkët anëtarët e një grupi sipërmarrës? | |
| Hapi 5 Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit për plotësimin e koncepteve kryesore. | |
| Demonstrim i rezultateve të arritura | |
| Hapi 6: Rrjeti i diskutimit Nxënësit ndahen në grupe dhe shkruajnë e argumentojnë mendimet e tyre. | |
| PO | A rezultoi biznesi me fitim? Pse? |
| JO | JO |

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- shpjegon rëndësinë e mbajtjes së llogarisë;
- ndjek të ardhurat e një biznesi;
- dallon shpenzimet në një biznes;
- përshkruan detyrat themelore të nevojshme për të drejtuar një biznes;
- bashkëvepron në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Me ndihmën e prindërve mendo hapat që duhet të ndiqni për ndërtimin e një sipërmarrjeje në rajonin tuaj.

Udhëzim për mësuesit.

Porositen nxënësit që me ndihmën e prindërve të zgjedhin një biznes që do të ndërtojnë dhe të mbajnë shënime për mënyrën e ndërtimit të një sipërmarrjeje.

Paraqiteni atë në një poster.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ / ____ / ____

| | | | |
|--|------------------------|---|-----------------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tema mësimore: Veprimtari praktike: Ne jemi sipërmarrës | | Situata e të nxënit: Krijimi i biznesit | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan detyrat themelore të nevojshme për të drejtuar një biznes;– ndjek të ardhurat e një biznesi;– shpjegon rëndësinë e mbajtjes së llogarisë;– dallon shpenzimet në një biznes;– deklaron ecurinë e një sipërmarrjeje;– bashkëvepron në grup. | | Fjalët kyçe: Shpenzimet, reklamimet, të ardhurat, fitim, humbje, shpenzim | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A4, mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, poster | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Vëzhgim-diskutim, Punë në grup/grupi i ekspertëve, Rrjeti i diskutimit</i> | | | |

Organizimi i orës së mësimi**Përshkrimi kontekstual i situatës:****Veprimtari paraprake: Hapi 1**

Ora e mësimi fillon me një prezantim e posterave të përgatitur nga nxënësit për sipërmarrjet e tyre.

Hapi 2

Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Pas vëzhgimit të posterave, nxënësit grupohen sipas sipërmarrjeve të ngjashme ose të përafërta. Kjo i ndihmon në realizimin e një sipërmarrjeje të thjeshtë.

Veprimet në situatë**Hapi 3**

Çfarë kanë të përbashkët anëtarët e një grupi sipërmarrës? Renditen disa cilësi të përbashkëta. Më pas çdo grup bashkëpunon për plotësimin e detyrave të biznesit të realizuar në mënyrë imagjinare sigurisht dhe paraqet tabelat për të ardhurat dhe shpenzimet.

Hapi 4

Lideri i grupit argumenton sipërmarrjen dhe tabelat duke paraqitur fitimin total të biznesit. Sipas rezultateve përzgjidhet grupi që ka fituar më shumë para.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 5: Rrjeti i diskutimit**

Nxënësit ndahen në grupe dhe shkruajnë e argumentojnë mendimet e tyre.

PO ☐ A mendoni se i keni cilësitë e nevojshme për të ngritur një sipërmarrje? Pse? ☐ JO

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënës/ja:**

- përshkruan detyrat themelore të nevojshme për të drejtuar një biznes;
- ndjek të ardhurat e një biznesi;
- shpjegon rëndësinë e mbajtjes së llogarisë;
- dallon shpenzimet në një biznes;
- deklaron ecurinë e një sipërmarrjeje;
- bashkëvepron në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Renditi mënyra që mund t'ju ndihmojnë të rrisni fitimet në biznesin tuaj. Bashkëpunoni me të rriturit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ / ____ / ____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|--|-----------------|---|----------|
| Tema mësimore: Sipërmarrësit zgjidhin probleme | | | Situata e të nxënit: Zgjidhja e problemit | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- identifikon disa nga rreziqet e mundshme të vendimeve të biznesit;- përshkruan rreziqet dhe përfundimet e vendimeve të biznesit;- analizon informacionin për një problem;- zbaton procesin e zgjidhjes së problemeve të biznesit- merr vendime të mirëvenduara;- bashkëvepron në grup. | | | Fjalët kyçe: Shpenzimet, përfitimet, rreziku, oferta, rrezik, reklama | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ , mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, postera, fletë të fotokopjuara. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pyetja sjell pyetjen, Loja “Bingo”, Përmbledhje pohim/mbështetje, Shkrim i lirë</i> | | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me paraqitjen e posterave të organizuara orën e mëparshme. Hapi 2 Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë. Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës përmes pyetjeve. – Cili nga bizneset ishte më fitimprurës? Po më pak fitimprurës? Si mund të shtohen përfitimet për grupin që nuk pati fitime? Veprimet në situatë: Hapi 3 Nxënësit veprojnë me lojën “Bingo” për renditjen e hapave për zgjidhjen e problemit. Nxënësit në dyshe njëri grup zgjedh numrin 1-5 dhe tjetri vendos zgjidhjen e problemit sipas rëndësisë. Hapi 4 Hapen librat dhe nxënësit bëhen leximtarë kritikë të tekstit duke përfutur teoritë për rrezikun e dështimit të biznesit, rolin e ofertave, përfitimeve dhe marrjen e vendimeve korrekte për mbarëvajtjen e një sipërmarrjeje. Hapi 5 Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit për plotësimin e fjalive me konceptet kryesore. | | | | |

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 6: Shkrim i lirë**

Nxënësit shkruajnë disa vendime që ndikojnë në rritjen e përfitimeve të biznesit. Më pas kalojnë në leximin e tyre dhe komentet përkatëse.

Vlerësimi i situatës**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- identifikon disa nga rreziqet e mundshme të vendimeve të biznesit;
- përshkruan rreziqet dhe përfundimet e vendimeve të biznesit;
- analizon informacionin për një problem;
- zbaton procesin e zgjidhjes së problemeve të biznesit
- merr vendime të mirëmbledhura;
- bashkëvepron në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Me ndihmën e prindërve mendo hapat që duhet të ndiqni për zgjidhjen e problemit të biznesit që pësoi humbje.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

| | | | |
|---|------------------------|--|-----------------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tema mësimore: Rajoni im në botë | | Situata e të nxënit: Ndërvarësia | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- shpjegon ndërvarësinë e ofruesve të burimeve;- tregon lidhjen e biznesit me konsumatorin;- zbaton zinxhirin e furnizimit në një shembull prodhimi;- bashkëvepron në grup. | | Fjalët kyçe: humbje, shpenzim, oferta, ndërvarësi, “biznesi komunitar”, furnizues, zinxhir furnizimi, përvoja e tregtimit | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ , mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvarësia Bashkëjetesa paqësore | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Vëzhgim-komentim, Lexim i drejtuar i tekstit, Pyetje-përgjigje</i> | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me një prezantim e fotove të një pajisjeje elektronike të zbërthyer ose e ndonjë Ipad ose TV të dalë jashtë përdorimi. Nxënësit lexojnë origjinën e tij. <i>Made in...</i> | | | |

Hapi 2

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen në këtë orë.

Nxitet të menduarit e nxënësve rreth temës përmes vëzhgim-komentim për bashkëveprimin dhe ndërvarësinë që ekziston mes firmave për realizimin e një sipërmarrjeje.

P.sh. një televizor ka: ekran – made in China, qarku – made in Vietnam, paneli – made in Poand etj.

Veprimet në situatë**Hapi 3**

Hapen librat e kalohet në leximin e drejtuar të tekstit. Vepohet për zbërthimin e kuptimit të tij të shoqëruar me fakte konkrete. Një pjesë e mirë e pajisjeve elektroshtëpiake janë shembull i ndërvarësisë dhe i zinxhirit të furnizimit.

Hapi 4

Mësuesi/ja zhvillon veprimtaritë në tekstin e nxënësit për plotësimin e koncepteve kryesore.

Demonstrim i rezultateve të arritura**Hapi 5**

Nxënësit në dyshe veprojnë për argumentimin e përgjigjes për pyetjen:

Pse të bësh tregti në vende të tjera mbart rreziqe, por edhe mundësi të mëdha fitimi?

Vlerësimi i situatës:**Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:**

- shpjegon ndërvarësinë e ofruesve të burimeve;
- tregon lidhjen e biznesit me konsumatorin;
- zbaton zinxhirin e furnizimit në një shembull prodhimi;
- bashkëvepron në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Me ndihmën e prindërve mendo hapat që duhet të ndiqni për ndërtimin e një sipërmarrjeje në rajonin tuaj dhe një grup tjetër për një sipërmarrje jashtë rajonit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ / ____ / ____


| | | | |
|--|------------------------|---|-----------------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tema mësimore: Veprimtari praktike: Sipërmarrje jashtë komunitetit | | Situata e të nxënit: Zgjidhja e sipërmarrësit | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan detyrat themelore të nevojshme për të drejtuar një sipërmarrje; - shpjegon ndërvarësinë e ofruesve të burimeve; - tregon lidhjen e biznesit me konsumatorin; - zbaton zinxhirin e furnizimit në një shembull prodhimi; - bashkëvepron në grup. | | Fjalët kyçe: reklamimet, të ardhurat, humbje, shpenzim, oferta, ndërvarësi, “biznesi komunitar”, furnizues, zinxhir furnizimi, përvoja e tregtimit | |

| | |
|---|--|
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ , mjete shkrimi, ngjyra, lapsa, videoprojektor | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Ndërvlerësimi Bashkëjetesa paqësore |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Vëzhgim-diskutim, Punë në grupe, Lojë roli, Debat</i> | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: Veprimtari paraprake: Hapi 1 Ora e mësimi fillon me vëzhgimin e një sipërmarrjeje në rajonin tonë dhe një tjetër përtej komunitetit. (jashtë rajoni) Hapi 2 Njihen nxënësit me temën e mësimi dhe rezultatet e të nxëniti që do të arrihen në këtë orë. Pas vëzhgimit të bizneseve nxënësit komentojnë për ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë mes tyre. P.sh. prodhimit të qumështit LUFRA e nënproduktet e tij në Shqipëri si dhe prodhimit të qumështit STERILGARDA në Itali. Veprimet në situatë: Hapi 3 Nxënësit, të ndarë në grupe sipas sipërmarrjeve brenda ose jashtë rajonale, bëjnë prezantim e tyre. Në këtë rast mund të bashkëveprohet edhe me ndihmën e ndonjë prindi specialist që përshkruan hallkat e zinxhirit të prodhimeve dhe furnizimeve. Hapi 4 Veprohet me lojë roli. Nxënësit tregojnë konkretisht përballjet e një sipërmarrësi që do të hapë një biznes jashtë rajonit me burimet, furnizuesit, shpërndarësit, konsumatorët. Demonstrim i rezultateve të arritura Hapi 5: Pyetje-përgjigje A duhet që vendet dhe furnizuesit të ndjekin të njëjtin kod sjelljeje? A ndikon ngrohja globale në ecurinë e bizneseve rajonale? Do të dëshironit të ishit pronar i një biznesi të madh apo të vogël? | |
| Vlerësimi i situatës Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – përshkruan detyrat themelore të nevojshme për të drejtuar një sipërmarrje; – shpjegon ndërvlerësimin e ofruesve të burimeve; – tregon lidhjen e biznesit me konsumatorin; – zbaton zinxhirin e furnizimit në një shembull prodhimi; – bashkëvepron në grup. | |
| Detyrat dhe puna e pavarur: Ndërto me ndihmën e prindërve planin e një biznesi jashtë rajonal. | |

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____ / ____ / ____

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|--|--|--|----------|
| Tema mësimore: Përsëritje: Çfarë mësuam për sipërmarrjen? Ose: Vizitë në një sipërmarrje rajonale | | | Situata e të nxënit: Sipërmarrja | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- tregon tiparet e sipërmarrësve të suksesshëm;- përcakton ndikimin e sipërmarrësve në komunitet;- identifikon burimet e sipërmarrjes;- shpjegon rrugët për zgjidhjen e problemeve të sipërmarrësve. | | | Fjalët kyçe: Shpenzimet, reklamimet, të ardhurat, humbje, oferta, ndërvarësi, “biznesi komunitar”, furnizues, zinxhir furnizimi, përvoja e tregtimit | |
| Burimet e informacionit dhe mjete: Njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, fletë A ₄ , mjete shkrimi, ngjyra, lapsa. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë, Pema e mendimit, Dramatizim, Shkrim i lirë | | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Përshkrimi kontekstual i situatës: | | | | |
| Veprimtari paraprake: Hapi 1 Zhvillohet loja “Bingo”. Mësuesi/ja përgatit për secilin grup etiketa me fjalët kyçe të kapitullit dhe shpjegimet e tyre përkatëse në etiketa të tjera të prera një nga një, p.sh.: | | | | |
| sipërmarrës | | Quhet një person që përdor burime të caktuara për të hapur një biznes. | | |
| Burime njerëzore | | Persona të kualifikuar për të prodhuar e shitur mallra. | | |
| Mallra | | Produkte që shiten dhe blihen. | | |
| oferta | | Sasia e një malli ose shërbimi që gjendet në treg për shitje. | | |
| Rajoni | | Zonë gjeografike me karakteristika të njëjta. | | |
| Nxënësi/ja që bashkon i pari të gjitha fjalët me shpjegimet e tyre, thërret “Bingo” dhe shpallet fitues i lojës. Mësuesi/ja mund të përfshijë edhe fjalë të tjera nga mësimi nëse e shikon të arsyeshme. | | | | |
| Hapi 2 Plotësojnë pemën e mendimit duke punuar në dyshe: | | | | |



Lexohet nga disa çifte.

Veprimet në situatë: Hapi 3

Punohet me nxënësit në grupe për dramatizimin e një situatë me sipërmarrësit me komponentët përbërës që shërbejnë për realizimin e biznesit. Si p.sh. pronarin e tokës, ndërtuesit e objektit, me administratën shtetërore për regjistrimin e biznesit, kompanitë që ofrojnë shërbimet, personat e kualifikuar, furnizuesit...

Hapi 4

Zgjidhet grupi që përfaqëson një sipërmarrje korrekte dhe bindëse për shokët.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Hapi 5: Shkrim i lirë

Nxënësit punojnë për detyrën sipërmarrja ime në të mirë të rajonit. Ata mund të përgatitin një listë ose një fletëpalosje me rregulla për realizimin e një sipërmarrjeje të suksesshme.

Vlerësimi i situatës

Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- tregon automjete të ndryshme;
- përcakton tipare të automjeteve të ndryshme;
- identifikon rregullat e pasagjerit në makinë;
- shpjegon përgjegjësitë e përdoruesve të rrugës.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruani mendimin tuaj rreth fjalisë “Një peshk i vogël dëshironte të notonte në pellg të madh.”

Kjo temë mund të realizohet nga mësuesi/ja edhe në formën e një ekskursioni në një sipërmarrje rajonale. Si detyrë mund të jepet: shkruani mbresat nga vëzhgimi i biznesit.

Detyra për portofolin e nxënësit

Emri/Mbiemri: _____

Data: _____

Grupet shoqërore ku bëj pjesë

1.

2.

3.

Përgjegjësitë e mia në grup

1.

2.

Emri/Mbiemri: _____

Data: _____

Të jem qytetar i mirë*Çfarë të bën ty një qytetar të mirë?*

Unë

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____
- 4 _____
- 5 _____
- 6 _____

Emri/Mbiemri: _____


Data: _____

Përfitimet nga puna vullnetare

*Nëse secili nga ne
bën punë vullnetare,
atëherë...*

Emri/Mbiemri: _____

Data: _____

Bëhu vullnetar***Shkruaj një letër nëpërmjet së cilës të ftosh shokët e tu për të formuar një grup vullnetar.***

Emri/Mbiemri: _____

Data: _____

Llojet e automjeteve

Shkruaj tipare të këtyre automjeteve.



.....

.....

.....

.....



.....

.....

.....

.....



.....

.....

.....

.....

Emri/Mbiemri: _____

Data: _____

Rregullat e pasagjerit në makinë
Shkruaj rregullat që duhet të zbatohmë si pasagjerë.




Diagram illustrating the rules for passengers in a car, centered around a child in a car seat. Six empty boxes are provided for writing rules, connected by arrows to the central image.

Top-left box:

Top-right box:

Left box:

Right box:

Bottom-left box:

Bottom-right box:

Çfarë mund të bëhet shkak për aksident në rrugë?

.....

.....

.....

Emër/Mbiemër:

Datë:

1. Çfarë kuptojmë me fjalën “grup”?

2. Çfarë të mirash dhe përgjegjësish ke kur je pjesë e një grupi shoqëror?

3. Trego cilësitë që duhet të ketë një drejtues grupi.

4. Plotëso fjalitë.

Kompromis _____.

Solidarë janë _____.

Vullnetarë janë _____.

Qytetar është _____.

5. A ke marrë pjesë në grupe vullnetare? Në cilat grupe? Me çfarë jeni marrë?

6. Cilat janë përfitimet e vullnetarëve nga shërbimet në komunitet?

7. Nëse banorët e pallatit tuaj hedhin mbeturinat pa kujdes dhe në vende të ndryshme, çfarë hapash do të ndiqnit për të zgjidhur problemin?

TEST – TREMUJORI I DYTË

Emër/Mbiemër:

Datë:

1. Çfarë cilësish duhet të ketë një kryetar bashkie që të votohet nga zgjedhësit? Rendit.

2. Pse është e nevojshme që organet e bashkisë të votohen nga banorët?

3. Trego disa nga detyrat e qeverisjes qendrore dhe të asaj vendore.

4. Plotëso fjalitë.

Pushteti vendor ka si qëllim _____.

Automjet quhet _____.

Qarku përbëhet nga _____.

Kryeqendër quhet _____.

5. Si mundet të parandalohen konfliktet ndërmjet përdoruesve të rrugës?

6. Cilat janë disa nga rregullat që duhet të zbatohet kur jemi pasagjerë?

7. Nëse udhëtojmë me mjete të transportit publik, çfarë do të sugjeroni për të qenë një pasagjer i mirë?

TEST – TREMUJORI I TRETË

Emër/Mbiemër:

Datë:

1. Çfarë e bën një sipërmarrës të suksesshëm? Rendit disa arsye.

2. Pse themi që bizneset e mëdha janë të ndërvarura?

3. Trego detyrat që duhet të realizojë një sipërmarrës për të krijuar biznesin.

4. Plotëso fjalitë.

Reklama ka si qëllim _____.

Zinxhir furnizimi quhet _____.

Burime kapitale janë _____.

Shpenzim quhet _____.

5. A mundet një sipërmarrës të ndërtojë një biznes pa njohur dhe përdorur burimet e rajonit?

6. Cilat janë hapat për zgjidhjen e problemit të një biznesi?

7. Nëse furnizuesit e huaj do të vononin papritmas transportimin, p.sh.: për mjetet e shkollës në fillim të vitit akademik, çfarë hapash do të sugjeronit për ta zgjidhur problemin?

Projekte të sugjeruara

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|--|-----------------|---|--|
| Tema mësimore: PROJEKT 1: Ne sjellim ndryshimin në komunitet | | Situata e të nxënit: Komuniteti | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> ndërmerr iniciativa në lidhje me përmirësimin e jetës në komunitet; vlerëson rëndësinë që ka kontributi i secilit për përmirësimin e jetës në komunitet; përcjell mesazhe ndërgjegjësuese për bashkëpunimin e të gjithë anëtarëve të komunitetit në veprimtari të përbashkëta. | | | Fjalët kyçe: komunitet, kontribut |
| Burimet e informacionit dhe mjetet: njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi, fletë formati A4, karton për postera, lapsa me ngjyra, lapustila, penela | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi, TIK |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve bisedë, diskutime, intervista, pyetje-përgjigje, punë në grup, punë individuale | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Qëllimi i projektit: Nxënësit studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri; zbulojnë faktorët që qëndrojnë në thellim të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë. Ata marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkëjetesën paqësore në shoqëri. | | | |
| Hapi 1: Bisedë Zhvillohet një bisedë rreth komunitetit, llojeve të tij. Shpjegohet me pak fjalë se si ndikon ai në jetën tonë. | | | |
| Hapi 2: Diskutojmë së bashku Pyeten nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> Cila ka qenë detyra juaj? (grumbullim informacioni për parqet e qytetit dhe hapësirat e gjelbra ose problem të tjera të komunitetit). Si vepruat? Ku u bazuat? Kush ju erdhi në ndihmë? | | | |

- Krahasoni me njëri-tjetrin të dhënat që keni sjellë.
- Përpiloni me to tabela e diagrame.
- Në cilat zona ka më shumë gjelbërim?
- Çfarë ndihmese mund të japim ne për të përmirësuar gjendjen?

Hapi 3: Punë në grupe

Nxënësit, të ndarë në grupe, përgatitin postera me temë “Ne sjellim ndryshimin”, të cilët ekspozohen në mjedise të ndryshme të shkollës.

Hapi 4: Punë në grup

Zbukurimi i mjedisit të shkollës me lule

Produkti që pritët:

Të tregojnë kujdes ndaj mjedisit ku jetojnë.

Mënyra e prezantimit: Veprimtari

Vlerësimi i situatës: *Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:*

- ndërmerr iniciativa në lidhje me përmirësimin e jetës në komunitet;
- vlerëson rëndësinë që ka kontributi i secilit për përmirësimin e jetës në komunitet;
- përcjell mesazhe ndërgjegjësuese për bashkëpunimin e të gjithë anëtarëve të komunitetit në veprimtari të përbashkëta.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|-----------------|--|----------|
| Tema mësimore: PROJEKT 2: Siguria në rrugë | | Situata e të nxënit: Rruga | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • regjistron nga media ose nga burime të tjera, raste të aksidenteve që kanë pasur si shkak sjelljen e gabuar të këmbësorit; • përgatit një përmbledhje me reflektime dhe këshilla për shokët, lidhur me përdorimin e sigurt të rrugës dhe të parqeve publike ku ndeshen njëkohësisht, përdorues të ndryshëm të tyre; • jep përfundimet e tij nga informacionet që merr për rrugët dhe ngjarjet që ndodhin në to. | | Fjalët kyçe: rrugë, aksident, rregull, përgjegjësi | |

| | |
|--|---|
| <p>Burimet e informacionit dhe mjetet: njohuritë paraprake të nxënësve, hartë e lagjes e marrë nga interneti dhe e printuar, materiale të siguruar nga mediat ose nga burime të tjera.</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi, TIK-u</p> |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve diskutim, punë në grupe, turi i galerisë</p> | |
| <p>Organizimi i orës së mësimi Qëllimi i projektit: Rruga ka rregullat e saj. Nëse nuk zbatohen rregullat në rrugë, ajo paraqet rrezik për të gjithë përdoruesit. Në këtë projekt, nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese për të gjetur dhe lexuar dokumente, fotografi që kanë të bëjnë me sigurinë rrugore. Ata zbatojnë aftësitë krijuese për të përgatitur postera, vizatime, albume.</p> | |
| <p>Udhëzime për zhvillimin e projektit Mësuesi/ja i ka udhëzuar nxënësit të marrin informacione në lidhje me aksidentet rrugore të kohëve të fundit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka ftuar në klasë prindër dhe punonjës policie nga komuniteti ku jetojnë nxënësit. • Nxënësit janë njohur më parë me temën e projektit. Ata kanë sjellë informacione në lidhje me temën. Përfaqësues të grupeve lexojnë informacionet e gjetura dhe diskutojnë rreth tyre. • Prezantimet shoqërohen me fotografi dhe me video të marra nga interneti, që lidhen me tematikën (materiale që i kanë përgatitur më parë me udhëzimin e mësueses). Nxënësit e grupeve të tjera bëjnë komentet e tyre rreth videove, fotografive dhe tregojnë përvojat e tyre në lidhje me çështjen që po diskutohet. | |
| <p>Vlerësimi i situatës: <i>Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistron nga media ose nga burime të tjera, raste të aksidenteve që kanë pasur si shkak sjelljen e gabuar të këmbësorit; • përgatit një përmbledhje me reflektime dhe këshilla për shokët, lidhur me përdorimin e sigurt të rrugës dhe të parqeve publike ku ndeshen njëkohësisht përdorues të ndryshëm të tyre; • jep përfundimet e tij/saj nga informacionet që merr për rrugët dhe ngjarjet që ndodhin në to; • bashkëpunon me të tjerët në veprimtari. | |
| | |

| | | | | |
|---|--|-----------------|---|----------|
| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | | Lënda: Qytetari | Shkalla: II | Klasa: V |
| Tema mësimore: PROJEKT 3: Sipërmarrësit e vegjël | | | Situata e të nxënit: Sipërmarrja | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">• përshkruan llojet e burimeve;• dallon produktet dhe shërbimet që ofrohen;• analizon produktet që përdoren;• përshkruan shërbimet që ofrohen;• përshkruan detyrat themelore të nevojshme për të drejtuar një biznes;• bashkëpunon me të tjerët. | | | Fjalët kyçe: sipërmarrje, sipërmarrës, sukses, reklamim, të ardhurat, fitim, humbje, shpenzim | |
| Burimet e informacionit dhe mjetet: njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi, fletë formati A4, karton për postera, lapsa me ngjyra, lapustila, penela. | | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi Mjedisi, TIK-u | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve bisedë, diskutime, intervista, pyetje-përgjigje, punë në grup, punë individuale | | | | |
| Organizimi i orës së mësimi Qëllimi i projektit: Nxënësit fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave e të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore, që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tij dhe të shoqërisë. Në këtë mënyrë mundësohet edhe realizimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë. Udhëzime për zhvillimin e projektit. Hapi 1: Bisedë - diskutim Zhvillohet një bisedë rreth bizneseve që veprojnë në komunitetin ku jetojnë nxënësit. Paraqiten fotografite e sjella nga nxënësit, të cilat paraqesin pamje të bizneseve të ndryshme. Hapi 2: Punë në grupe Nxënësit në grupe përgatitin planin për hapjen e një biznesi. | | | | |

Hapi 3: Diskutim

Prezantim i punës së grupeve

Produkti që pritët:

Të përgatitin planin për hapjen e një biznesi.

Mënyra e prezantimit: Veprimtari

Vlerësimi i situatës: *Situata konsiderohet e realizuar nëse nxënësi/ja:*

- përshkruan llojet e burimeve;
- dallon produktet dhe shërbimet që ofrohen;
- analizon produktet që përdoren;
- përshkruan shërbimet që ofrohen;
- bashkëpunon me të tjerët.